



Qendra Kosovare për Studime Gjinore  
Kosovar Center for Gender Studies

# **INDIKATORËT PËR MONITORIMIN E SITUATËS SË TANISHME NË KOSOVË PËRKITAZI ME DHUNËN KUNDËR GRAVE**

## **Përmbajtja**

### **I. Përmbledhja Ekzekutive**

1. Përgjegjësia e shtetit: organet speciale, planet e veprimit, buxheti dhe përputhja me normat ndërkombëtare
2. Ligjet substanciale dhe procedurale për mbrojtjen nga të gjitha format e dhunës kundër grave
3. Ligje apo rregullore speciale (rregullore të brendshme, protokole, udhëzime) dhe plane të koordinuara afatgjata ose afatmesme të veprimit për profesione të ndryshme që merren me rastet e dhkg-ve
4. Njësitë speciale në zyrat për zbatimin e ligjit
5. Shërbimet në dispozicion
6. Arsimi dhe aftësimi
7. Mediat
8. Aktivitete për ngritjen e vetëdijes
9. Hulumtime dhe anketa
10. Statistikat dhe mbledhja e të dhënave
11. Praktika gjyqësore

## INDIKATORËT PËR MONITORIMIN E SITUATËS SË TANISHME TË VENDEVE PËRKITAZI ME DHUNËN KUNDËR GRAVE

**Duke u bazuar në Rekomandimin REC 2002(5) të Komitetit të Ministrave të Këshillit të Evropës për shtetet anëtare lidhur me dhunën kundër grave<sup>1</sup>, në harmoni me Deklaratën e Kombeve të Bashkuara për Eliminimin e Dhunës kundër Grave dhe të Rekomandimit të Përgjithshëm 19 të Komitetit CEDAW të Kombeve të Bashkuara**

### Përmbledhje

- Pas miratimit të Ligjit për Barazinë Gjinore 2004/2, u themeluan një sërë institucionesh të cilat merren me barazinë gjinore. Më 1 shkurt 2005, Qeveria e Kosovës, me vendimin Nr. 5/31, themeloi Zyrën për Barazi Gjinore. Në bazë të Ligjit për Barazi Gjinore 2004/2, institucioni kryesor përgjegjës për politikën gjinore është Zyra për Barazi Gjinore, e cila është pjesë e Zyrës Këshilluese për Qeverisje të Mirë në Zyrën e Kryeministrit.
- Në vitin 2004, Qeveria e Kosovës miratoi Planin Kombëtar të Veprimit për Arritjen e Barazisë Gjinore, ku përfshihen rekomandimet për trajtimin e diskriminimit gjinor në Kosovë.
- Qeveria e Kosovës nuk ka vijë të veçantë buxhetore për masat të cilat ndërmerren për të luftuar dhunën kundër grave.
- Në kuadër të Shërbimit Policor të Kosovës vepron një njësi kundër dhunës në familje, e cila merret me rastet e dhunës në familje, përfshirë edhe dhunën kundër grave.
- Deri në vitin 2005, Buxheti i Konsoliduar i Kosovës nuk ka siguruar kurrfarë përkrahje për OJQ-të e angazhuara në përpjekje të luftimit të dhunës kundër grave. Kjo mbase vjen nga pamundësia buxhetore për shkak të buxhetit shumë të vogël.
- Nuk ka të vendosur një sistem financiar që trajton kompensimin e dëmeve të shkaktuara ndaj viktimave të dhunës, mirëpo institucionet dhe OJQ-të e ndryshme ofrojnë këshilla ligjore dhe shërbime falas për strehimin e viktimave.
- Plani Kombëtar i Kosovës për Barazinë Gjinore parasheh që të gjitha ligjet duhet të harmonizohen me të gjitha konventat dhe rezolutat evropiane, përfshirë Konventën për Eliminimin e të gjitha Formave të Diskriminimit kundër Grave (KEDKG, ang. CEDAW), si dhe Rezolutën 1325 të Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara.
- Për shkak të statusit të saj politik, Raportuesi Special për Dhunën kundër Grave nuk ka dorëzuar raport për Kosovën.

<sup>1</sup> Gjatë përgatitjes së indikatorëve, burimet në vijim janë përdorur si shembull: Korniza Monitoruese e bazuar në indikatorët e përgatitur nga Grupi i Specialistëve për Zbatimin e Rekomandimeve Përcjellëse Rec (2002)5 të Komitetit të Ministrave të Shteteve Anëtare lidhur me Mbrojtjen e Grave nga Dhuna

- Në Kosovë nuk ka ndonjë ligj të veçantë për dhunën kundër grave (DHKG, ang. VAW). Ka një rregullore që në mënyrë të zhdrejtë e trajton dhunën kundër grave: gjatë trajtimit të rasteve të dhunës kundër individëve – qoftë në familje ose në vende publike. Kjo nuk e trajton në mënyrë të veçantë dhunën kundër grave, por dhunën e ushtruar kundër të gjithë personave.
- Kodi i përkohshëm penal i Kosovës dhe rregullorja kundër dhunës familjare i kanë thjeshtësuar masat për luftimin e dhunës kundër grave.
- Pas miratimit të ligjit kundër dhunës familjare, gjyqet e shohin zgjidhjen e rasteve të dhunës familjare si më të rëndësishme.
- Njësia për Avokim dhe Ndihmë për Viktimat dhe Gjyqi Suprem i Kosovës janë të obliguara që të ndërmarrin masa për dënimin e shkaktarëve të dhunës familjare dhe t'u ofrojnë mbrojtje viktimave.
- Në këtë Ligj (penal) dhe në Ligjin për Dhunën Familjare ka dispozita që trajtojnë rastet e dhunës kundër grave (DHKG). Rastet e DHKG gëzojnë të drejtën e kompensimit. Për shembull, nëse një grua e cila ka pësuar nga dhuna në familje vendosë që të shkurorëzohet prej burrit, ajo mund të fitojë dëmshpërblim ose pronën e tij.
- Njësia për Avokim dhe Ndihmë Viktimave (NJANV) vepron në përputhje me legjislacionin në fuqi, siç është Kodi i Përkohshëm Penal i Kosovës, Ligji Kundër Dhunës Familjare dhe Ligji Kundër Diskriminimit.
- Në Kosovë nuk ka ndonjë ligj i cili do t'i mbronte zyrtarët dhe nëpunësit që punojnë nëpë vendstrehime ose në vende të tjera ku u ofrohen shërbime rateve të dhunës kundër grave.
- Janë një numër i OJQ-ve të cilat po ashtu ofrojnë falas ndihmë ligjore para dhe pas procedurës.
- Ligji për Dhunën Familjare kërkon nga institucionet si Qendrat e Punës Sociale, Shërbimi Policor i Kosovës dhe nga sistemi gjyqësor që të bashkërendisin punën e vet.
- Rrjeti Kosovar i Grave (RRKG) është themeluar në vitin 2000 si një rrjet joformal i organizatave joqeveritare të grave të shpërndara në tërë Kosovën.
- Zyra për çështje gjinore në kuadër të Zyrës së Kryeministrit, e cila është hapur në vitin 2005, mëton të avokojë në favor të barazisë gjinore në qarqet vendimmarrëse, duke involvuar edhe OJQ-të në hartimin, zhvillimin dhe në vlerësimin e zbatimit të legjislacionit. Ky mekanizëm institucional ende nuk ka një “mekanizëm sistematik” për kyçjen e OJQ-ve në proceset ligjore.
- Përkundër mungesës së mekanizmave sistematike për kyçjen e tyre, OJQ-të kosovare kanë ndërmarrë nisma për inicimin dhe pjesëmarrjen në hartimin e ligjeve që e përcaktojnë fushën e barazisë gjinore.

INDIKATORËT PËR MONITORIMIN E SITUATËS SË TANISHME NË KOSOVË PËRKITAZI ME DHUNËN KUNDËR GRAVE

- Qendra për Mbrojtjen e Grave dhe Fëmijëve (QMGF) është e vendosur në Prishtinë dhe ka nën-degët e veta në tërë Kosovën. Ajo përqendrohet në çështjet që kanë të bëjnë me dhunën kundër grave dhe fëmijëve.
- Për momentin nuk ka ndonjë plan afatmesëm apo afatgjatë veprimi për profesionet në dosjen e dhunës kundër grave.
- Në Kosovë ekzistojnë pesë vendstrehime kryesore dhe me dhjetëra vendstrehime të vogla dhe të besueshme për viktimat e dhunës. Megjithatë, të dhënat e sakta për vendndodhjen e tyre nuk mund të publikohen me qëllim të ruajtjes së besueshmërisë së këtyre vendstrehimeve dhe, rrjedhimisht, edhe për ruajtjen e sigurisë së klientëve të vendosur në to. Megjithatë, disa të dhëna të përgjithshme janë në dispozicion.
- Në Kosovë është në dispozicion së paku një linjë S.O.S., e cila ofron dy lloje të shërbimeve: përkrahje emocionale dhe një linjë për raste të trafikimit.
- Qendra për Mbrojtjen e Grave dhe Fëmijëve i ka dy qendra të krizave për vendosje dhe strehim emergjent të viktimave.
- Për momentin në Kosovë nuk ka një program për trajtimin e kundërvajtësve.
- Të gjithë oficerët e Shërbimit Policor të Kosovës janë të obliguar të vijnë trajnime, në të cilat ata/ato mësojnë si të merren në mënyrë profesionale me llojet e ndryshme të dhunës, përfshirë dhunën familjare, dhunën fizike, dhunën seksuale dhe trafikimin.
- Një sërë trajnimesh ofrohen nga OJQ-të vendore dhe ndërkombëtare përkitazi me çështjet gjinore dhe, ndonjëherë, me dhunën kundër grave.
- Nuk ka ndonjë program tjetër të përhershëm arsimor që merret vetëm me të drejtat e njeriut.
- Nuk ka ndonjë rregullore ose ligj ku do të përcaktohej profile i dhunës kundër grave; nuk ka, po ashtu, as udhëzime, rregulla të sjelljes apo udhëzim të veçantë administrative që do t'u dedikohej mediave kosovare për këto raste.
- Shumica e mjeteve të informimit në nivelin vendor ose qendror kanë përkrahur një ose më shumë fushata për të alarmuar opinionin publik lidhur me dhunën kundër grave; kjo zakonisht është bërë në bashkëpunim me ndonjë OJQ aktive në këtë fushë.
- Gjatë pesë vjetëve të fundit janë zhvilluar dhe zbatuar një numër i madh i fushatave kundër dhunës kundër grave.
- Shumë OJQ të angazhuara në këtë fushë kanë botuar broshura ose informacione të tjera më të plota lidhur me këtë çështje të rëndësishme.
- Qendra Kosovare për Studime Gjinore është një organizatë hulumtuese, e përkushtuar për të sjellur çështjet gjinore në qendër të vëmendjes në të gjithë sektorët e shoqërisë kosovare përmes ngritjes së vetëdijes gjinore, rritjes së përqendrimit në çështjet gjinore

**INDIKATORËT PËR MONITORIMIN E SITUATËS SË TANISHME NË KOSOVË PËRKITAZI ME DHUNËN KUNDËR GRAVE**

në sistemin arsimor kosovar, zhvillimit të studimeve gjinore, dhe përmes hartimit dhe miratimit të politikave të ndjeshme në çështjet gjinore në të gjithë sektorët e jetës.

- Shteti nuk ka zhvilluar indikatorë për rastet e dhunës kundër grave, e as hulumtime për të siguruar të dhëna të ndryshme për to.
- Qendra për Mbrojtjen e Grave dhe Fëmijëve i publikon konstatimet e veta në një raport vjetor, ku përfshihen të gjitha format e dhunës kundër grave: dhuna seksuale, dhuna familjare dhe incesti.
- Roli i institucionit të Obudspersonit në Kosovë ka mbetur në një nivel krejtësisht informues sa i përket dhunës kundër grave

## **1. PËRGJEGJËSIA E SHTETIT: ORGANET SPECIALE, PLANET E VEPRIMIT, BUXHETI DHE PËRPUTHJA ME NORMAT NDËRKOMBËTARE**

**1.1 A ekziston në vend ndonjë mekanizëm për barazinë gjinore (ndonjë organ qeveritar ose departament përgjegjës për këtë sektor)? Nëse ekziston ndonjë mekanizëm i tillë, atëherë a ngarkohet ky mekanizëm me detyra konkrete në fushën e dhunës kundër grave? Nëse është kështu, paraqitni një listë të këtyre detyrave. A ka buxhet të alokuar për këtë qëllim? Nëse po, sa është shuma (vjetore)?**

**A ka ndonjë raport vlerësues nga shteti ose nga OJQ-të lidhur me përmbushjen e këtyre detyrave ose për monitorimin e përparimeve në këtë fushë?**

Pas luftës në Kosovë, Rezoluta 1244 e Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara e ngarkoi Misionin e Kombeve të Bashkuara në Kosovë (UNMIK) me detyrën e administrimit të Kosovës deri në kohën e përcaktimit të statusit të saj final politik, duke i dhënë Përfaqësuesit Special të Sekretarit të Përgjithshëm (PSSP) pushtet të plotë. Populli i Kosovës i zgjodhi institucionet demokratike, përfshirë edhe kuvendet në nivel të komunave dhe në nivel qendror të qeverisë. Pasi që UNMIK-u është autoriteti më i lartë i pushtetit, të gjitha ligjet në fuqi një herë janë miratuar në Kuvend të Kosovës e pastaj janë dekretuar nga PSSP-ja. UNMIK-u ka filluar bartjen graduale të pushtetit tek institucionet vendore. Në një situatë të këtillë unike të ndarjes së pushtetit ndërmjet UNMIK-ut dhe qeverisë së zgjedhur, ndodh që shpesh të jenë në veprim forma dhe mekanizma të shumtë për sigurimin e barazisë gjinore, të vendosura si në kuadër të administratës së UNMIK-ut ashtu edhe në institucionet vendore.

Pas miratimit të Ligjit për Barazinë Gjinore 2004/2, janë themeluar një varg institucioneve që merren me barazinë gjinore. Më 1 shkurt 2005 është themeluar Zyra për Barazi Gjinore me vendimin nr. 5/31 të Qeverisë së Kosovës. Në bazë të Ligjit për Barazi Gjinore 2004/2, institucioni kryesor për politikën gjinore është Zyra për Barazi Gjinore, e cila është pjesë e Zyrës Konsultative për Qeverisje të Mirë në Zyrën e Kryeministrit. Kjo Zyrë i bashkërenditë veprimet e veta me Zyrën Konsultative për Qeverisje të Mirë, të Drejta të Njeriut, për Mundësi të Barabarta dhe për barazi gjinore në Zyrën e Kryeministrit, të themeluara në zbatim të rregullores së UNMIK-ut nr. 2001/19 – shtojca e parë. Kjo zyrë financohet nga Buxheti i Konsoliduar i Kosovës. Linja buxhetore i takon buxhetit vjetor të Zyrës së Kryeministrit e cila nuk ka vija të veçanta për zyra të ndryshme.

Struktura të tjera që merren me barazinë gjinore janë Zyrat për Çështje Gjinore, të vendosura nëpër qeveritë komunale, si dhe nënkomisioni për Çështje Gjinore në Kuvendin e Kosovës.<sup>2</sup> Të gjitha këto financohen nga Buxheti i Konsoliduar i Kosovës, përmes kuvendeve vendore. Qeveria e Kosovës githashtu ka themeluar një grup ndërministror, i cili ka për qëllim bashkërenditjen e aktiviteteve në mes të institucioneve të ndryshme përkitazi me çështjet gjinore.<sup>3</sup>

Një Zyrë për Çështje Gjinore vepron në kuadër të administratës së UNMIK-ut, mirëpo kjo nuk ka ndonjë sektor të vetin i cili do të merrej me çështjen e dhunës kundër grave.<sup>4</sup> Në bazë të Rregullores së UNMIK-ut nr. 2000/38, Zyra e Ombudspersonit është përgjegjëse për diskriminimin në bazë gjinore. Megjithatë, kjo zyrë shërben më shumë si burim informimi se sa ndonjë mekanizëm i dobishëm. Më herët kjo zyrë financohej nga UNMIK-u, ndërkaq që nga viti 2006 financohet nga Buxheti i Konsoliduar i Kosovës.

<sup>2</sup> See <http://www.AssemblyofKosovo.org>.

<sup>3</sup> Neni 2, Rregullorja 2/2005 për themelimin e administratës së përkohshme të Zyrës për Barazi Gjinore.

<sup>4</sup> Rregullorja nr. 2004/18 për shpalljen e Ligjit për Barazinë Gjinore në Kosovë, e miratuar nga Kuvendi i Kosovës.

Në fund, përkundër mekanizmave të shumtë për barazinë gjinore brenda UNMIK-ut dhe qeverisë kosovare, asnjë prej tyre nuk ka të përshkruara detyra të veçanta për të vepruar në fushën e dhunës kundër grave. Pos kësaj, nuk ka as ndonjë institucion ose departament i veçantë që merret me dhunën kundër grave.

Përfaqësuesit e pesë vendstrehimeve kryesore nëpër tërë Kosovën, kohëve të fundit u takuan me Ministrin e Punës dhe Mirëqenies Sociale për të kërkuar përkrahje për arsye se të gjitha viktimat e dhunës ndaj grave janë drejtuar nga policia dhe nga institucionet ndërkombëtare që të kërkojnë ndihmë pikërisht nga këto vendstrehime. Këto institucione u ankuan që përkundër shërbimeve të natyrës qeveritare që ofrojnë, ato nuk përfitonin pothuajse kurrfarë përkrahje nga qeveria.<sup>5</sup>

**1.2 A ka ndonjë institucion ose organ koordinues qeveritar i ngarkuar me zbatimin e masave për luftimin e dhunës kundër grave (përgjegjëse për monitorimin dhe vlerësimin e rregullt, si dhe për konsultime të rregullta ndërmjet palëve relevante shtetërore, OJQ-ve dhe ekspertëve)? Nëse është kështu, atëherë cilat janë detyrat dhe aktivitetet e saj? A ka ndonjë raport vlerësues për aktivitetet e këtij organi dhe cilat janë përfundimet kryesore të këtij raporti? Sa është buxheti vjetor për funksionimin e këtij organi/institucioni dhe si ndahet shuma në mes të aktiviteteve të ndryshme? Sa punëtorë janë të angazhuar në të dhe cilat janë kualifikimet e tyre?**

Megjithëse ekziston Zyra për Barazinë Gjinore në kuadër të Zyrës së Kryeministrit, ajo nuk ka asnjë sektor ose organ të veçantë që do të merrej me monitorimin, vlerësimin dhe koordinimin e masave për luftimin e dhunës kundër grave.

**1.3 A ka ndonjë Plan Kombëtar të Veprimit për Luftimin e Dhunës kundër Grave? Nëse është kështu, atëherë shikoni pyetjet në vijim. A ka një Plan Kombëtar të Veprimit për Barazinë Gjinore? Nëse po, a ka dispozita speciale përkitazi me dhunën kundër grave? Ju lutemi për rastet e mësipërme tregoni për tipin e veprimeve duke përfshirë afatet, personat përgjegjës dhe buxhetin e alokuar.**

**A ka ndonjë raport/raport të përparimit të përgatitur nga Shteti lidhur me zbatimin e Planeve të Veprimit? A ka raporte të tilla nga OJQ-të?**

Në vitin 2004, Qeveria e Kosovës ka miratuar Planin Kombëtar të Veprimit për Arritjen e Barazisë Gjinore, dhe ky plan paraqet rekomandimet për trajtimin e problemeve dhe të rrethanave specifike të diskriminimit gjinor në Kosovë. Si mekanizëm për barazi gjinore, Plani Kombëtar për Arritjen e Barazisë Gjinore ishte shkruar për t'iu përgjigjur nevojave të grave të Kosovës. Ky ishte hartuar në kontekstin e lëvizjeve ndërkombëtare për përmirësimin e pozitës dhe të statusit të grave dhe propozon hapa konkretë që Kosova të lëvizë në drejtim të arritjes së barazisë gjinore dhe të zhvillimit.

Me qëllim të mbrojtjes dhe avansimit të të drejtave të njeirut në Kosovë, Kryeministri ka sjellë një vendim për themelimin e Njësisë së të Drejtave të Njeriut në secilën ministri të Qeverisë së Kosovës. Njësia e të Drejtave të Njeriut, në bashkëpunim me Zyrën për Qeverisje të Mirë, do të ndihmojë në zbatimin e dokumenteve të miratuara nga Qeveria e Kosovës dhe do të jetë drejtpërsëdrejti përgjegjëse për zbatimin e rekomandimeve të Institucionit të Ombudspersonit në lidhje me implementimin e legjislacionit të të drejtave të njeriut. Ato kanë po ashtu një rol të rëndësishëm në hartimin e dokumenteve në fushën e të drejtave të njeriut, që do të ndihmojë drejtpërsëdrejti në zbatimin e Standardeve për Kosovën dhe në procesin e

<sup>5</sup> Shih [www.womensnetwork.org/main%20page%20files/Newsletter.pdf](http://www.womensnetwork.org/main%20page%20files/Newsletter.pdf) për më shumë informata për këtë takim dhe për kërkesat e tyre.



ardhshëm të raportimit të të drejtave të njeriut në Kosovë. Më 11 tetor 2005, Kryeministri i Kosovës nënshkroi Udhëzimin Administrativ Nr. 8/2005 ku përshkruhen detyrat e Njësisë për të Drejtat e Njeriut në Qeverinë e Kosovës. Zyrtarët e Njësisë për të Drejtat e Njeriut do të mbulojnë këto aspekte të të drejtave të njeriut: mundësitë e barabarta (në lidhje me implementimin e ligjit kundër diskriminimit), barazinë gjinore (në pajtim me ligjin për barazinë gjinore), të drejtat e fëmijëve, të drejtat e minoriteteve (komuniteteve), të drejtat e njerëzve me aftësi të kufizuara, si dhe përpjekjet kundër trafikimit të qenieve njerëzore.<sup>6</sup>

Më 11 tetor 2005, Qeveria e Kosovës e miratoi Planin e Veprimit për implementimin e Ligjit kundër Diskriminimit (nr. 4/170), i cili bënë prioritetizimin e veprimeve sipas rëndësisë, cakton afate dhe ndanë përgjegjësitë për institucionet e involvuara, duke propozuar përshkrimin e hollësishëm të nevojave për financimin dhe implementimin e planit nga Buxheti i Konsoliduar i Kosovës.

Megjithatë, Plani Kombëtar i Veprimit për Arritjen e Barazisë Gjinore nuk përfshinë edhe një plan veprimi për luftimin e dhunës kundër grave. Po ashtu, mungon edhe buxheti i dedikuar për luftimin e dhunës kundër grave. Udhëheqësja e Zyrës për Barazi Gjinore, Znj. Visare Gorani, në një intervistë të mëhershme tha se: “Në vitin 2006 planifikojmë të kryejmë hulumtime në lidhje me këtë problem dhunën kundër grave, mirëpo ende nuk është bërë alokimi i buxhetit”.<sup>7</sup>

**1.4 A ka ndonjë dokument apo rregullore që synon luftimin e dhunës kundër grave ose të formave të ndryshme të manifestimit të saj? Nëse po, ju lutemi të jepni një përmbledhje të drejtëve të veprimit dhe aktivitetet këtij dokumenti. A ka ndonjë raport vlerësues lidhur me zbatimin?**

Sipas Drejtorit të Drejtorisë për Legjislacion në Zyrën për Qeverisje të Mirë, Abit Asllani, “Ende nuk kemi një politikë të veçantë për luftimin e formave të ndryshme të dhunës kundër grave”.<sup>8</sup> Ai thekson se Zyra për Barazinë Gjinore po planifikon që së shpejti të bëjë diçka konkrete në këtë drejtim.

**1.5 A ka një mekanizëm shtetëror sistematik të rishikimit (raport i rregullt i progresit etj) lidhur me legjislacionin dhe politikën e tashme në fushën e dhunës kundër grave? Nëse po, si funksionon ky mekanizëm dhe kush është përgjegjës për rishikimin? A ka ndonjë rol të caktuar për OJQ-të në këtë mekanizëm?**

Drejtoria për Legjislacion dhe Drejtoria për Monitorim dhe Raportim, e cila vepron brenda Zyrës për Barazinë Gjinore në Zyrën e Kryeministrit, deklaroi se e monitoron në mënyrë sistematike zbatimin e ligjeve në Kosovë lidhur me mbrojtjen e grave viktime të dhunës dhe reagon kur identifikon raste të shkeljes së ligjit. Ata e bëjnë këtë duke monitoruar zbatimin e duhur të ligjit dhe në rastet e shkeljeve të ligjit i raportojnë Zyrës së Kryeministrit. Megjithatë, kjo zyrë ende nuk ka publikuar asgjë lidhur me dhunën kundër grave as për punën e vet në monitorimin e zbatimit të legjislacionit për dhunën kundër grave. Kjo mbase për arsye se kjo zyrë është formuar në vitin 2005 dhe ka shumë pak kohë që ka filluar së funksionuari. Në kuadër

<sup>6</sup> Zyra e Kryeministrit për Qeverisje të Mirë, Të Drejta të Njeriut, për Mundësi të Barabarta dhe për Barazi Gjinore: Raport tremujor për aktivitetet në këtë fushë kundër diskriminimit, korrupsionit dhe trafikimit të qenieve njerëzore, korrik-shtator 2005, Prishtinë, faqe 31.

<sup>7</sup> Intervistë personale me Visare Goranin, Udhëheqëse e Zyrës për Barazi Gjinore si pjesë e kabinetit të Kryeministrit, zhvilluar më 30 janar 2006.

<sup>8</sup> Intervistë personale me Abit Asllanin, Drejtor i Drejtorisë për Legjislacion në Zyrën për Qeverisje të Mirë në Zyrën e Kryeministrit, zhvilluar më 28 janar 2006.

të Zyrës për Barazinë Gjinore është një Drejtori që është përgjegjëse për bashkëpunimin me OJQ-të. Kështu, në të ardhmen, OJQ-të do të duhej të jenë më shumë të përfshira në monitorimin e legjislacionit dhe të politikave të tashme lidhur me dhunën kundër grave.

## 1.6 Buxheti shtetëror

**1.6.1 A ka një linjë buxhetore në buxhetin shtetëror dhe në atë të komunave për luftimin e dhunës kundër grave ose të formave të ndryshme të saj? Nëse po, ju lutemi të emëroni përfituesit, llojin e veprimeve dhe shumën vjetore. A ka një linjë në buxhetin qendror të Shtabit të Forcave të Policisë, të Zyrës së Prokurorit, të Sistemit Gjyqësor, të Shërbimeve Kombëtare të Mbrojtjes Sociale, të Mbrojtjes së Familjes dhe të Fëmijëve, si dhe të Sistemit të Mbrojtjes Shëndetësore për luftimin e dhunës kundër grave apo të formave të ndryshme të manifestimit të saj?**

Sipas Drejtorit të Drejtorisë për Legjislacion në Zyrën për Qeverisje të Mirë, Z. Abit Asllani, nuk ka asnjë linjë të veçantë buxhetore për veprimet që e luftojnë dhunën kundër grave. Megjithatë, në kuadër të buxhetit të përgjithshëm të Zyrës për Barazi Gjinore ka mundësi të ndarjes së buxhetit për realizimin e projekteve që kanë të bëjnë me dhunën kundër grave. Këtë e ka vërtetuar edhe Udhëheqësi i Zyrës për Barazi Gjinore në kuadër të Kabinetit të Kryeministrit, Znj. Visare Gorani. Megjithatë, pasi që kjo është një zyrë e re, buxheti i saj ende nuk është përdorur për qëllime të luftës kundër DHKG.

Në kuadër të Shërbimit Policor të Kosovës ekziston një njësi që vepron kundër dhunës në familje, përfshirë dhunën kundër grave. Në buxhetin e përgjithshëm të SHPK-së ekziston një linjë buxhetore për veprimin e njësitit për dhunën në familje. Pos aktiviteteve në hetimin e rasteve të dhunës në familje, kjo njësi merr pjesë edhe në aktivitete të tjera, si fushatat për ndërgjegjësimin e qytetarëve për dhunën kundër grave, e të tjera.

Njësia për avokim dhe ndihmë viktimave (NJANV) është një njësi në kuadër të Gjyqit Suprem të Kosovës, e cila u ofron ndihmë viktimave gjatë proceseve gjyqësore, këshilla dhe përfaqësim falas në seancat gjyqësore. Kjo përfshinë edhe emërimin e avokatit mbrojtës. Nëse viktima nuk ka strehim, njësia e vendosë atë në një nga vendstrehimet e udhëhequra nga OJQ-të. Ndonjëherë, njësia u ofron kompensim në të holla shtëpive e sigurta që kujdesen për strehimin e viktimave.

Arta Kelmendi, udhëheqëse e Njesisë për Avokim dhe Ndihmë Viktimave, tha në një intervistë, se: “Në vitin 2005, në bashkëpunim me OSBE-në, me Zyrën e Kryeministrit, me Ministrinë e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë dhe me Zyrën Amerikane në Kosovë, kemi udhëhequr një projekt kundër trafikimit të qenieve njerëzore. Kjo fushatë ka zgjatur dy javë me qëllimin kryesor ndërgjegjësimin e qytetarëve lidhur me trafikimin. Kështu për shembull, është bërë fushatë se si të mbrohet popullata dhe të rinjtë nga trafikimi. Ne kemi hartuar dhe shpërndar broshura, kemi mbajtur ligjerata për shkollat e mesme dhe e kemi publikuar nëpër media numrin e telefonit në të cilin mund të thërrasin viktimat e trafikimit”.<sup>9</sup>

Në fund, përderisa nuk ka një linjë të veçantë buxhetore që merret me dhunën kundër grave në SHPK, në Zyrën e Prokurorit, në Sistemin Gjyqësor, në Shërbimin Kombëtar për Mbrojtjen Sociale, në Mbrojtjen e Fëmijëve dhe të Familjes ose në Sistemin e Mbrojtjes Shëndetësore, megjithatë të gjitha këto kanë linja të përgjithshme buxhetore të cilat e mbulojnë fushën e dhunës kundër grave. Në këtë moment, nuk ka linja të ndara buxhetore për këtë fushë.

<sup>9</sup> Intervistë personale me Arta Kelmendin, 3 shkurt 2006, udhëheqëse kosovare e Njesisë për Avokim dhe Ndihmë Viktimave.

**1.6.2 A ka një shumë vjetore për përkrahjen nga Shteti (autoritetet) të OJQ-ve që janë aktive në fushën e DHKG? Nëse po, sa është kjo shumë? Nëse jo, sa mjete ishin ndarë nga Shteti për këto OJQ në vitin e fundit kur janë dhënë mjete për këtë veprimtari?**

Para luftës së vitit 1999, vetëm disa OJQ merreshin me çështjen e dhunës kundër grave.<sup>10</sup> Me përfundimin e luftës dhe me vendosjen e administratës ndërkombëtare në Kosovë, numri i OJQ-ve të angazhuara në fushën e pozitës së grave, përfshirë edhe dhunën kundër tyre, është rritur dukshëm. Shumica e këtyre OJQ-ve kosovare ishin dhe ende financohen nga OJQ të ndryshme ndërkombëtare.

Deri në vitin 2005, Buxheti i Konsoliduar i Kosovës nuk ka paraparë kurrfarë ndihme për OJQ-të aktive në fushën e DHKG-së. Kjo mbase do të ketë ardhur nga buxheti vërtetë i vogël në dispozicion. Në disa raste, gjatë fushatave, trajnimeve, ose konferencave për DHKG-në, institucionet kanë marrë pjesë duke bashkëpunuar e ndonjëherë edhe duke bashkëfinancuar këto aktivitete. Një shembull i këtij bashkëpunimi ka qenë projekti kundër trafikimit të qenieve njerëzore, në të cilën morën pjesë institucione të ndryshme, përfshirë Zyrën e Kryeministrit për Qeverisje të Mirë, Ministrinë e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë, Njësinë për Avokim dhe Ndhimë Viktimave dhe OJQ-ve të ndryshme ndërkombëtare si IOM-i, e të tjera.<sup>11</sup>

**1.7 A ka të vendosur një sistem për kompensimin e viktimave? Nëse po, përshkruajeni sistemin shkurtimisht. Tregoni për numrin (vjetor) të përfituesve dhe për shumën e të hollave të shpërndara, si dhe numrin e viktimave përfituese të DHKG-së si dhe shumën e përgjithshme të të hollave të shpërndara.**

Nuk ka një sistem financiar që merret me kompensimin e dëmeve të shkaktuara viktimave të dhunës; megjithatë, institucionet dhe OJQ-të ofrojnë shërbime falas për strehimin e viktimave dhe këshilla ligjore. Një shembull tipik për këtë është Njësia për Avokim dhe Ndhimë Viktimave, e cila vepron në kuadër të Gjyqit Suprem të Kosovës. Kjo njësi u ofron viktimave ndihmë dhe këshilla falas gjatë proceseve gjyqësore, përfaqësim para gjyqit, dhe u siguron strehim. Njësia për Avokim dhe Ndhimë Viktimave në disa raste u ofron të holla shtëpive të sigurta të cilat i marrin viktimat në përkujdesje.

**1.8 A janë çështja e DHKG-së dhe siguria e grave të pranishme në ligjet, rregulloret dhe udhëzimet kombëtare, rajonale dhe lokale?**

Plani Kombëtar i Veprimit i Kosovës për Barazi Gjinore parasheh që të gjitha ligjet duhet të harmonizohen me të gjitha konventat dhe rezolutat evropiane, përfshirë Konventën për Eliminimin e të gjitha Formave të Diskriminimit kundër Grave (KEFDG) dhe Rezolutën 1325 të Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara. Planet në nivelin kombëtar, rajonal dhe komunal janë në fazë të hartimit. Ende nuk dihet nëse DHKG-ve dhe siguria e grave do të merren parasysh.

**1.9 Cilat janë brengat kryesore lidhur me DHKGNë në Komentet Përmbyllëse të Komitetit të KEFDG-së për vendin tuaj? A ka ndërmarrë Shteti hapa konkret për të zbatuar Rekomandimet e Komitetit?**

Vetëm shtetet e pavarura dhe të njohura ndërkombëtarisht mund të jenë palë nënshkruese e KEFDG-së. Pasi që Kosova ende nuk e ka statusin e një vendi të pavarur, ajo nuk mund të jetë

<sup>10</sup> Intervistë personale me Visare Goranin, Udhëheqëse e Zyrës për Barazi Gjinore si pjesë e kabinetit të Kryeministrit, zhvilluar më 30 janar 2006

<sup>11</sup> Intervistë personale me Arta Kelmendin, 3 shkurt 2006, udhëheqëse kosovare e Njësisë për Avokim dhe Ndhimë Viktimave.

palë nënshkruese e KEFDG-së. Abit Asllani, Drejtor i Drejtorisë për Legjislacionin i Zyrës për Qeverisje të Mirë brenda Kabinetit të Kryeministrit, theksoi në një intervistë se Korniza Kushtetuese e Kosovës (zëvendësim për një kushtetutë të mirëfilltë shtetërore) i ka parasysh rekomandimet e KEFDG-së. Ligji kundër të gjitha formave të diskriminimit është në harmoni me këtë konventë. Kësisoj, Kosova e ka krijuar mekanizmin për zbatimin e KEFGD-së.<sup>12</sup>

### **1.10 Cilat ishin shqetësimet kryesore në raportin e Raportueses Speciale të KB-ve lidhur me dhunën kundër grave në vendin tuaj?**

Për shkak të statusit politik të Kosovës, Raportuesja Speciale e KB-ve për Dhunën Kundër Grave nuk ka dorëzuar raport për Kosovën.

## **2. LIGJET SUBSTANCIALE DHE PROCEDURALE PËR MBROJTJEN NGA TË GJITHA FORMAT E DHUNËS KUNDËR GRAVE**

### **2.1 A ka një ligj special për dhunën kundër grave? Nëse po, si definohet DHKG-ja, cilat forma të dhunës i mbulon dhe cilat janë dispozitat kryesore? Nëse jo, atëherë a ka ndonjë ligj special për forma të ndryshme të DHKG-së (dhuna familjare, trafikimi, etj.)?**

Nuk ka ndonjë ligj të veçantë për DHKG-në Kosovë. KA disa ligje të ndryshme që merren me DHKG-në në mënyrë të tërthortë, në trajtimin e dhunës kundër individëve – qoftë në familje ose në vende publike. Ky nuk e trajton DHKG-në në mënyrë specifike, por më parë dhunën kundër të gjithë personave. Ligji për Barazinë, Ligji kundër Diskriminimit, Rregullorja për Dhunën Familjare dhe Rregullorja kundër Trafikimit të Qenieve Njerëzore janë forma të tjera të legjislacionit të cilat në mënyrë të tërthortë e përcaktojnë fushën e DHKG.

Rregullorja për Dhunën Familjare (2003/12) krijon legjislacion të veçantë për dënimin e shkaktarëve të dhunës në familje si dhe për mbrojtjen e viktimave të dhunës familjare.

Sipas Rregullores së UNMIK-ut 2001/4 kundër trafikimit të qenieve njerëzore, konsiderohet krim përfshirja në trafikimin e qenieve njerëzore (dënimet lëvizin prej 2 deri 20 vjet, varësisht nga rasti) dhe të merret e të mbahet paraporta e dikujt (dënimi lëvizë prej 1 deri 5 vjet, varësisht nga rasti).

Ligji kundër Diskriminimit 2004/03, në paragrafin 2 obligon “trajtim të barabartë, pa diskriminim të drejtëpërdrejtë ose të tërthortë kundër një personi për shkak të gjinisë, moshës, statusit martesor, gjuhës, paaftësisë fizike apo mendore, qëndrimit politik, besimit ose religjionit, përkatësisë etnike ose sociale, etj.”

### **2.2 Ligji penal**

#### **2.2.1 Si definohen dhe si klasifikohen veprimet kriminale, si dhe cilat janë dënimet?**

Kodi i Përkohshëm Penal i Kosovës, i cili është në fuqi që nga data 6 prill 2004, ka krijuar bazën ligjore për luftimin e të gjitha formave të veprimtarisë kriminale. Dhuna në familje rregullohet dhe sanksionohet shumë mirë në kodin e përkohshëm penal të Kosovës. Disa aspekte të dhunës kundër grave, si për shembull abuzimi seksual, sanksionohet në Nenin 192 të Kodit të Përkohshëm Penal të Kosovës. Sipas Rregullores së UNMIK-ut 2003/25 për zbatimin e Kodit të Përkohshëm Penal të Kosovës dhe Rregullorja e UNMIK-ut 2001/4 për ndalimin e trafikimit të të qenieve njerëzore në Kosovë Neni 19 “Është krim përfshirja në trafikimin e qenieve njerëzore

<sup>12</sup>Intervistë personale me Abit Asllanin, Drejtor i Drejtorisë për Legjislacionin në Zyrën për Qeverisje të Mirë në Zyrën e Kryeministrit, zhvilluar më 28 janar 2006.

(dënimet lëvizin prej 2 deri 20 vjet, varësisht nga rasti) dhe të merret e të mbahet paraporta e dikujt (dënimi lëvizë prej 1 deri 5 vjet, varësisht nga rasti)”.

### **2.2.2 A ka ndonjë rrethanë rënduese ose shpjeguese përkitazi me DHKG-në, në pjesë lidhur me dënimet? Nëse po, ju lutemi t'i përshkruani shkurtimisht.**

Kodi i Përkohshëm Penal i Kosovës dhe rregullorja kundër dhunës familjare i ka thjeshtësuar veprimet në luftën kundër DHKG-së. Sipas Raportit Vjetor 2004 të OJQ-së Qendra për Mbrojtjen e Grave dhe të Fëmijëve, “Kodi i përkohshëm penal i Kosovës përcakton se për lëndime të lehta trupore, nëse kundërvajtësi është në marrëdhënie familjare, dënimi do të jetë më i rëndë”.<sup>13</sup>

### **2.2.3 A ka procedura speciale, dispozita procedurale (mundësia e procedurave të përshpejtuara, etj.)?**

Pas miratimit të Rregullores Kundër Dhunës në Familje (2003/12), gjyqet u kanë dhënë përparësi zgjidhjes së rasteve të dhunës në familje.

Në disa raste, kjo është për shkak të pamundësisë për të strehuar viktimat për një periudhë më të gjatë kohore. Sipas togerit të SHPK-së, Z. Besim Berisha, zyrtar i njësisë për dhunën në familje, departamenti i SHPK-së për krime serioze ka hasur në disa raste kur “viktimat femra të dhunës familjare nuk kanë mundësi strehimi, kështu që gjykata duhet të procedojë rastin me urgjencë”.<sup>14</sup>

Sipas Valbona Salihut, juriste e OJQ-së Shoqata e Juristeve “Norma”, kriteri themelor për vlerësimin e përparësisë së rasteve për gjykim është si në vijim: “Lëndët gjyqësore procedohen ashtu që rastet me burgim të mëhershëm ose me rrezikshmëri të lartë kanë përparësi. Nëse lënda e dhunës kundër grave konsiderohet si e natyrës emergjente, atëherë ajo do të procedohet menjëherë”.<sup>15</sup> Pasi që të lajmërohet rasti i dhunës familjare në polici dhe pasi që policia ta ketë konfirmuar ekzistimin e dhunës, viktimat duhet të vendosë nëse do të ngrisë kundër shkaktarit të dhunës. Nëse ajo vendosë të ngrisë aktpadi, atëherë gjykata duhet të procedojë rastin menjëherë. Në rastet e DHKG-së jashtë familjes, lënda procedohet sipas procedurave të rregullta.

### **2.2.4 A ka urdhëra paralajmërimi, mbrojtjeje, apo ndalimi në sistemin ligjor?**

Në bazë të dispozitave të Rregullores Kundër Dhunës Familjare (2003/12), Njësia për Avokim dhe Ndihmë Viktimave dhe Gjyqi Suprem i Kosovës janë të obliguar të ndërmarrin masa për dënimin e shkaktarëve të dhunës familjare dhe t'u ofrojnë mbrojtje viktimave. Më tutje, rregullorja parasheh ( në Nenin 2.1c) që në rastet e dhunës në familje Njësia për Avokim dhe Ndihmë Viktimave duhet të urdhërojë mbrojtje emergjente nëse vlerësohet e nevojshme. Kjo mund të përfshijë strehimin, urdhëra parandaluese për një distancë minimale të caktuar dhe për të mos e shqetësuar viktimën. Nëse shkaktori e shkel këtë urdhër, ai do të arrestohet atypëraty dhe do të mbahet në burg për 72 orë. Në ndërkohë gjykata duhet menjëherë ta procedojë rastin. Policia ruan të drejtën për ta mbajtur shkakтарin në burg më gjatë se 72 orë nëse kanë arsye të besojnë se kundërvajtësi mund të dëmtojë viktimën prapë.

<sup>13</sup> Qendra për Mbrojtjen e Grave dhe të Fëmijëve, Raporti Vjetor 2004, Përmbledhja numër 5, Prishtinë, 2005

<sup>14</sup> Intervistë personale me togerin Besim Berisha më 1 janar 2006, zyrtar në sektorin për dhunë familjare të Drejtorisë për krime serioze.

<sup>15</sup> Intervistë personale me Valbona Salihun më 2 shkurt 2006, juriste e OJQ-së “Norma” Shoqata e Avokateve

### **2.2.5 Në cilat raste aplikohet ndjekja sipas detyrës zyrtare (*ex-officio*) qoftë nga policia apo nga prokurori, dhe kur është e domosdoshme kërkesa e viktimës për të filluar procedurën gjyqësore? A janë policia të obliguar t'i regjistrojnë dhe t'i hetojnë të gjitha rastet e lajmëruara?**

Siç u tha më lartë, nëse viktima e dhunës familjare kërkon fillimin e procedurës, lënda duhet të procedohet menjëherë. Policia i regjistron faktet, mirëpo varet nga viktima nëse ai/ajo dëshiron të ngrisë padi ose jo; por në rastet kur kemi të bëjmë me dhunën brutale që mund të vërehet lehtë. Kjo më shumë i takon praktikës policore të reagimit në situata konkrete. Në raste të tjera, siç është trafikimi, procedura fillon menjëherë. Nëse kërkesa e viktimës është e domosdoshme për fillimin e procedurës, atëherë kjo nuk është sipas detyrës zyrtare.

Sipas rregulloreve të brendshme të policisë, ata janë të obliguar t'i hetojnë dhe t'i regjistrojnë të gjitha rastet e lajmëruara. Madje edhe në rastet kur individët thërrasin e pastaj i mohojnë akuzat e mëparshme, nga policia kërkohet që ta hetojnë dhe ta regjistrojnë rastin. Sipas togerit të SHPK-së Z. Besim Berisha, kur policia pranon një thirrje për DHKG-në, procedura është si në vijim: Së pari, dërgohet një patrullë policore për të konfirmuar nëse thirja ka qenë e vërtetë dhe nëse ka pasur dhunë. Nëse ka pasur dhunë, atëherë dërgohet njësi special, i cili gjendet në secilin stacion policor. Zakonisht, këto njësite përbëhen nga dy oficerë policie (një mashkull dhe një femër), të cilët janë të trajnuar enkas për t'u marrë me raste të dhunës familjare. Nëse për shkak të natyrës së dhunës së ushtruar, gruaja nuk pranon të flasë para policëve, atëherë policia e kryen intervistimin në një dhomë të ndarë. Nëse policia konstaton se ka pasur dhunë, ata atypëraty e arrestojnë kundërvajtësin ose për mungesë të personit e shpallin arrestin. Lënda dërgohet në gjykatë menjëherë.<sup>16</sup>

### **2.2.6 A është dhuna kundër grave dhe fëmijëve element rëndues ose vendimtar për të marrë vendim për ndjekje në mbrojtje të interesit publik?**

Normat sociale të bazuara në traditë dhe në kode jozyrtare, siç është për shembull “Kanuni i Lekë Dukagjinit” shpeshherë ndërhyjnë në zbatimin e vendimeve të gjykatës lidhur me dhunën kundër grave dhe fëmijëve.<sup>17</sup> Vendimi për të filluar procedurë të ndjekjes në interes publik është një faktor vështirësues sepse ngatërrohet me vlerat tradicionale të kodeve jozyrtare. Kodi i Lekë Dukagjinit, ose thjeshtë “Kanuni”, është një tërësi ligjesh të hartuara nga Lekë Dukagjini dhe të përdorura kryesisht në Shqipërinë e veriut nga shekulli i 15-të deri në shekullin e 20-të dhe i ringjallur së voni pas rënies së regjimit komunist në fillim të viteve të nëntëdhjeta të shekullit të kaluar. Kjo ishte një tërësi e ligjeve zakonore, e bartur brez pas brezi dhe e pakodifikuar dhe e pashkruar deri në shekullin e nëntëmbëdhjetë. Për herë të parë këtë kod e kompiloi Atë Shtjefën Gjeçovi. Megjithëse Kanuni i atribuohet princit shqiptar Lekë Dukagjinit, rregullat e tij kanë evoluar me kalimin e kohës me qëllim që të vendoset rendi në këto troje. Kanuni ishte i ndarë në disa pjesë: Kisha, Familja, Martesa, Shtëpia, Kafshët dhe Prona, Puna, Bartja e Pronës, Fjala e Dhënë, Nderi, Dëmshpërblimi, Ligji lidhur me krimet, E drejta juridike, dhe Lëshimet e Përrjashtimet.

### **2.2.7 A ka dispozita speciale në mbrojtje të fëmijëve (përfaqësimi ligjor, insticiumi i procedurave, etj.)?**

Dispozitat e Rregullores kundër Dhunës Familjare (2003/12) kanë krijuar legjislacion të veçantë për dënimin e kundërvajtësve të dhunës familjare, si dhe për mbrojtjen dhe ofrimin e ndihmës

<sup>16</sup> Po aty.

<sup>17</sup> Kodi i Lekë Dukagjinit, ose shkurt “Kanuni” (ose “Canon” në gjuhën angleze).

për viktimat. Po ashtu, nëse fëmijëve u duhet strehim, Njësia për Avokim dhe Ndihmë Viktimave, në bashkëpunim me Qendrat për Punë Sociale, marrin përgjegjësinë për sigurimin e strehimit. Për momentin, megjithëse nuk ka ndonjë dispozitë e cila parasheh në mënyrë specifike për fëmijët, ata mbulohen nga Ligji për Familjen dhe nga Rregullorja kundër Dhunës Familjare dhe, sëkëndejm, gëzojnë të drejtat për mbrojtje dhe për përfaqësim ligjor sikur të gjithë personat e tjerë.

**2.2.8 A sanksionohet dhuna nëse shkaktohet ose tolerohet nga shteti ose nga zyrtarët e tij (veçanërisht në burgje, në qendra korrektuese, në institucione psikiatrike, etj.)? Nëse po, ju lutem të prezantoni shkurtimisht dispozitat përkatëse. Çfarë lloj sanksionesh mund të aplikohen?**

Ligji Kundër Diskriminimit (nr. 2004/03), i cili në paragrafin 2 (a) e thekson “trajtimin e barabartë, që nënkupton mosdiskriminim të drejtëpërdrejtë ose të tërthortë kundër një personi për shkak të gjinisë, moshës, statusit martesor, gjuhës, paaftësisë psikike ose fizike, bindjes politike, religjionit ose besimit, përkatësisë etnike ose sociale, etj.”. Nëse shkaktori i dhunës është shteti, një person mund të ngre padi kundër shtetit në Gjykatën Supreme dhe në Institucionin e Ombudspersonit. Sanksionet janë të rregulluara në bazë të Kodit të Përkohshëm Penal të Kosovës.

**2.3 A ka ndonjë dispozitë të veçantë në ligjin civil apo në ligjin për familjen lidhur me rastet e dhunës kundër grave, përfshirë dëmshpërblimin, kompensimin për dëmet financiare dhe jo-financiare? A ka ligje ose dispozita të veçanta (procedurë të përshpejtuar, etj.)? A ka dispozita të veçanta për mbrojtjen e fëmijëve? A ka dispozita të veçanta në rastet e dhunës familjare përkitazi me shkurorëzimin, banimin (përdorimi i banesës së njëjtë) dhe të drejtën e vizitës/kujdestarisë ndaj fëmijës?**

Ligji i Martesës dhe i Familjes kodifikon të drejtat e individit brenda familjes. Ligji ndahet në dhjetë pjesë. Pjesa e tretë i përcakton procedurat e martesës, raportet ndërmjet prindit dhe fëmijës, dhe lidhur me ushqimin.

Në kuadrë të Ligjit dhe Rregullores kundër Dhunës Familjare, ekzistojnë dispozitat për rastet e DHKG-së brenda shtëpisë. Rastet e DHKG-së kanë të drejtë për kompensim. Për shembull, nëse gruaja e cila ka vuajtur nga dhuna familjare vendosë të shkurorëzohet nga burri i vet, ajo mund të marrë kompensim prej tij ose pronën e tij. Nuk ka dispozita speciale për ta proceduar rastim. Siç u tha edhe më lartë, fëmijët mbulohen nga legjislacioni i njëjtë si edhe të gjithë personat e tjerë.<sup>18</sup>

**2.4 Mbrojtja e viktimave dhe mbrojtja e dëshmitarëve**

**2.4.1 A ka ndonjë ligj (ose dispozitë) të veçantë për mbrojtjen e viktimave dhe mbrojtjen e dëshmitarëve? A ka dispozita të veçanta lidhur me DHKG-në? Nëse po, ju lutem t'i përshkruani shkurtimisht.**

Njësia për Avokim dhe Ndihmë Viktimave (NJANV) vepron në përputhje me legjislacionin aktual, siç është Kodi i Përkohshëm Penal i Kosovës, Rregullorja Kundër Dhunës Familjare dhe Ligji Kundër Diskriminimit. Procedurat janë si në vijim. Në bazë të procedurave të cilat përputhen me ligj: pas raportimit të një rasti nga policia, ose pasi që NJANV-ja kontaktohet drejtpërsëdrejti, Njësia e cakton një zyrtar nga NJANV-ja si mbrojtës të viktimës. Pastaj ai apo

<sup>18</sup> Shih Ligji për Dhunën Familjare 2003/12, dispozita 14.

ajo do të caktojë një avokat mbrojtës, i cili do të angazhohet falas. Nëse viktimat nuk ka strehim, ai ose ajo do t'i sigurojë strehim. Në disa raste, NJANV-ja i paguan kompensim OJQ-së vendstrehimit nga të hollat për strehimin e viktimave. Viktima përcillet deri në fund të gjykimit. Edhe NJANV-ja ka numrat e telefonit në të gjitha rajonet ku viktimat mund të informohen për të drejtat e veta. Mbrojtja e dëshmitarëve është e rregulluar përmes kodit të përkohshëm penal të Kosovës. Paragrafi 14.3 g parasheh mbrojtje jo vetëm për viktimën por edhe për palët e treta dëshmitarët e dhunës.

**2.4.2 A ka dispozita speciale të marrjes në pyetje për t'iu shmangur viktimizimit të sërishtëm, përsëritjes së dëshmisë, biseda hetimore në kushte të veçanta (dëshmia para kamerës, dhoma të veçanta të hetimit)? Nëse po, ju lutem t'i përmendni shkurtimisht. Në sa raste të dhunës kundër grave janë përdorur këta mekanizma (ose në vitin e kaluar)?**

Policia i ka rregullat e saj të brendshme për këto çështje. Këto janë dispozita të rregullores së brendshme policore e cila rregullon procedurën e veprimit. Ato janë në harmoni me Rregulloren kundër Dhunës Familjare.

Në rastet kur kjo është e domosdoshme, policia e angazhon një oficer femër për të kryer intervistimin e victimës. Nëse viktimat është e pasigurtë, ajo duhet të dërgohet në NJANV. Gjatë marrjes në pyetje nga policia, viktimat ka të drejtë të japë deklaratën e saj në një dhomë të ndarë. Intervista e parë regjistrohet, nënshkruhet nga viktimat dhe i dërgohet gjykatës. Viktimat dëshmojnë për herë të dytë në gjykatë. Nëse dhuna e kryer ka qenë e ndjeshme për nga natyra (si dhunë seksuale, incest, etj), atëherë NJANV-ja do të sigurojë një avokate për të.

Neni 7.3 i Ligjit për parandalimin e Trafikimit të Qenieve Njerëzore në Kosovë 2001/4 thekson se i mbetet gjykatësit të vendosë nëse do të përdorë ose jo dëshminë e incizuar të victimës si dëshmi zyrtare të saj. Nëse gjykatësi konstaton se dëshmia e këtillë nuk siguron provë të mjaftueshme, ai/ajo mund të kërkojë nga ajo që të dëshmojë prapë në gjykatë. Në rastet e trafikimit, gjykatësi do të kujdeset për atë se cilat pyetje mund t'i bëhen victimës e cilat nuk bën të bëhen në gjykatë. Megjithatë, në rastet e DHKG-ve që nuk përkohjnë me trafikimin, nuk ka kushte të veçanta të cilat lidhen me viktimizimin dytësor, me përsëritjen e dëshmisë, ose me marrjen në pyetje nën kushte të veçanta.

**2.4.3 A ka dispozita të veçanta të ligjit për ruajtjen e të dhënave në rastet e DHKG-ve? Nëse është kështu, ju lutem t'i paraqisni shkurtimisht. Nëse nuk ka të tilla, atëherë a ka dispozita të përgjithshme që mund të zbatohen në këto raste?**

Togeri Besim Berisha thekson se anonimiteti i victimës është i garantuar pa marrë parasysh rrethanat. Kjo sigurohet përmes një rregulloreje të brendshme, e cila është në harmoni me kodin e përkohshëm penal të Kosovës. Kjo informatë nuk mund të përdoret nga një palë e tretë.<sup>19</sup> Anonimiteti i victimës duhet të ruhet në çdo rast.

**2.4.4 Cilat janë dispozitat kryesore ligjore të ruajtjes së fshehtësisë profesionale në rastet e dhunës seksuale kundër fëmijëve?**

Kodi i Përkohshëm i Kosovës, që ka hyrë në fuqi më 6 prill 2004, ka krijuar legjislacionin e duhur për luftimin e të gjitha formave të aktiviteteve kriminale. Ky ligj përmbanë dispozitat lidhur me fshehtësinë profesionale në lidhje me dhunën seksuale kundër fëmijëve.<sup>20</sup>

<sup>19</sup> Intervistë personale me togerin Besim Berisha, zyrtar në sektorin e dhunës familjare në Drejtorinë për krime serioze, bërë më 01.01.2006.

<sup>20</sup> Intervistë personale me Valbona Salihu, juriste nga OJQ "Norma", më 02.02.2006



#### **2.4.5 A ka dispozita speciale në ligj që i mbrojnë zyrtarët profesionalë dhe ofruesit e shërbimeve në fushën e DHKG-së?**

Nuk ka ligje të veçanta për mbrojtjen e zyrtarëve dhe profesionistëve të ndryshëm që punojnë në strehimore ose në vende të tjera ku ofrohen shërbime për rastet e DHKG-së.

#### **2.4.6 A ka dispozita speciale për mbrojtjen e fëmijëve?**

Për mbrojtjen e fëmijëve veprojnë ligjet e njëjta të cilat i mbrojnë të gjithë personat e tjerë. Megjithatë, këto janë në harmoni me të gjitha konventat evropiane për të drejtat e fëmijëve. Valbona Salihu thotë se sipas ligjit kundër dhunës familjare, në rastet kur rrezikohen fëmijët, ata strehohen në shtëpitë e sigurta së bashku me nënat e veta. Po ky ligj parasheh që NJANV-ja është përgjegjëse për ndërmarrjen e masave mbrojtëse në rastet kur fëmijët janë viktimat. Në të shumtën e rasteve, të njëjtat shtëpi të sigurta që strehojnë gratë shërbejnë edhe për strehimin e fëmijëve.

#### **2.5 A ka ndihmë ligjore gratis për viktimat e DHKG-ve para dhe gjatë procedurave? A u mundësohet viktimave të përfshira në procedura që të kenë qasje në përfaqësim dhe ndihmë ligjore nga organizata private dhe publike të cilat veprojnë në këtë fushë? Kush e siguron mbështetjen financiare për këto shërbime? Cilat janë kushtet për shfrytëzimin e këtyre shërbimeve?**

Pas raportit përkatës policor, i cili do të dëshmonte se ka pasur dhunë, të gjitha viktimat kanë të drejtë për ndihmë ligjore gratis nga institucionet përkatëse private dhe publike në vijim.

NJANV-ja është një njësi publike në kuadër të Gjyqit Suprem të Kosovës. Kjo njësi ofron ndihmë, këshilla ligjore dhe përfaqësim ligjor falas për të gjitha viktimat për të gjitha viktimat, para dhe gjatë procedurës gjyqësore, gjithnjë në përputhje me nevojat e veçanta të viktimës. Të jeni viktimë dhe të keni nevojë për ndihmë.

Sipas NJANV-së, në disa raste njësi i kompenson materialisht OJQ-të të cilat ofrojnë strehim për gratë. Megjithatë, strehimoret thonë se kjo nuk ndodh rregullisht. NJANV-ja po ashtu, në secilin regjion, i ka vënë në dispozicion numrat e telefonave në të cilat mund të paraqiten viktimat dhe ku mund të marrin falas ndihmë juridike. Fondet sigurohen nga buxheti i NJANV-së, i cili financohet nga mjetet e Buxhetit të Konsoliduar të Kosovës.

Ekzistojnë po ashtu edhe disa OJQ të cilat ofrojnë ndihmë juridike falas para dhe gjatë procedurave. Më aktivet në këtë fushë janë Shoqata e Grave e Gjakovës, Shoqata e Avokateve "Norma", si dhe Qendra për Mbrojtjen e Grave dhe Fëmijëve, e cila ka degët dhe lokalet e veta nëpër tërë Kosovën. Këto financohen kryesisht nga donatorë ndërkombëtarë. Shoqata e Avokateve "Norma", është një OJQ kosovare e themeluar pas luftës dhe ofron falas ndihmë juridike, përfshirë edhe këshillime për viktimat para dhe gjatë gjykimit. Aktivitetet e shoqatës kryesisht përqendrohen në ofrimin e ndihmës juridike falas gjatë procedurave të së drejtës civile, si për shembull shkurorëzimet, të drejtat pronësore, etj. Kjo OJQ nuk ofron shërbime juridike në lëndët penale, por vetëm në ato civile. Për lëndët e të drejtës penale organizata i drejton klientët në Qendrën për Mbrojtje të Grave dhe Fëmijëve (QMGF), e cila siguron falas ndihmë edhe përfaqësim juridik.

**2.6 A ka ndonjë kërkesë ligjore për të informuar viktimat e përfshira në procedura lidhur me të drejtat e tyre dhe obligimet, si dhe për shërbimet në dispozicion ku mund të kërkojnë ndihmë?**

Rregullorja kundër Dhunës Familjare 2003/12, në dispozitat e saj 14.3 **a** dhe **b** kërkon nga të gjitha organet për zbatimin e ligjit për të informuar viktimat lidhur me të drejtat e obligimet e tyre, por edhe për shërbimet në dispozicion për t'i ndihmuar. NJANV-ja është një njësi e Gjyqit Suprem të Kosovës, e cila është përgjegjëse të caktojë një këshilltar për viktimën, i cili pastaj merr përsipër të këshillojë viktimën dhe të gjejë një avokat mbrojtës për periudhën e gjykimit.

**3. LIGJE APO RREGULLORE SPECIALE (RREGULLORE TË BRENDSHME, PROTOKOLE, UDHËZIME) DHE PLANE TË KOORDINUARA AFATGJATA OSE AFATMESME TË VEPRIMIT PËR PROFESIONE TË NDRYSHME QË MERREN ME RASTET E DHKG-VE**

Shënim: informatat e mbledhura duhet të mbulojnë të gjitha profesionet relevante për zbatimin e ligjit (përfshirë profesionet që licencohen, si për shembull psikiatria): policia, prokurorët, gjykatat, shërbimet për mbrojtjen e fëmijëve dhe të familjes, zyrat për migrim e të tjera.

**3.1 Ju lutemi të ofroni listën e profesioneve të cilat përcaktohen nga ligje speciale, kode detyrimore ose nga udhëzime të tjera për t'u marrë me rastet e DHKG-së? Cilat janë dispozitat kryesore të këtyre ligjeve dhe kodeve? A ka rregulla speciale për incizimin, hetimin ose regjistrimin e rasteve, përfshirë kushtet (për shembull kërkesat që duhen plotësuar që policia të incizojë dhe të hetojë të gjitha rastet)? Cilat janë përmbytjet kryesore, mjetet dhe formularët kryesorë të incizimeve, të regjistrimeve, dhe të dokumentacionit (ku shpjegohet përkatësia gjinore, lidhja ndërmjet viktimës dhe kundërvajtjesit, veprat e mëparshme të dhunës, etj.). A ka rregulla të hollësishme e udhëzime për dëgjimin e dëshmisë dhe për trajtimin e viktimës, si dhe mbledhjen e provave dhe të informatave?**

Neni 14 i Rregullores kundër Dhunës Familjare parasheh përgjegjësitë e organeve për zbatimin e ligjit, ku përfshihen edhe transportimi i sigurt i viktimave, arrestimin e shkaktarëve të dhunës, informimin e viktimave për ndihmën në dispozicion, ofrimin e ndihmës juridike, kujdesin shëndetësor, etj. Sipas po këtij ligji, zbatuesit e ligjit duhet të mbledhin dokumentacionin e rëndësishëm gjatë regjistrimit të rasteve, i cili duhet të bëjë dallimin e gjinive dhe të përfshijë informacionin për lidhjen ndërmjet viktimës dhe kundërvajtjesit, etj. Kjo përfshinë rregullat dhe udhëzimet e hollësishme për dëgjimin e dëshmisë dhe për trajtimin e viktimave dhe për mbledhjen e provave e të informatave. Siç u tha më lartë, politikat e brendshme kërkojnë nga policia të reagojë, të hetojë dhe të incizojë të gjitha thirrjet lidhur me DHKG-në. Sipas këtij ligji të gjitha organet për zbatimin e ligjit duhet të veprojnë në përputhje me të. Kjo nënkupton, për shembull, profesionet e oficerëve të policisë, avokatët, gjykatësit, dhe zyrtarët e tjerë të organeve për zbatim të ligjit.

**3.2 A ka ndonjë kërkesë ligjore për punë të koordinuar ndërmjet agjencioneve të ndryshme, dhe për bashkëpunim ndërmjet autoriteteve të ndryshme?**

Rregullorja kundër Dhunës në Familje kërkon nga institucionet publike, përfshirë Qendrat e Punës Sociale, Shërbimin Policor të Kosovës, dhe sistemin gjyqësor, që të koordinojnë punën e tyre. Ligji po ashtu sugjeron që institucionet publike të bashkëpunojnë me OJQ-të dhe me strehimoret.

### **3.3 Bashkëpunimi ndërmjet organizatave**

**3.3.1 A ka një forum që mundëson bashkëpunim aktiv ndërmjet OJQ-ve që veprojnë në këtë fushë dhe autoriteteve shtetërore? Nëse po, si duket ky forum? A përfshinë përfaqësues të komunitetit shkencor, vendimmarrësit politik dhe organet legjislative, shëndetësore, arsimore, sociale dhe policore?**

Rrjeti Kosovar i Grave (RRKG) është themeluar në vitin 2000 si rrjet zyrtar i organizatave joqeveritare (OJQ) të grave me shtrirje në tërë Kosovën. Anëtarët joqeveritarë të këtij rrjeti ofrojnë një varg shërbimesh në bashkësitë e veta. Disa merren me çështje të dhunës kundër grave, trafikimin dhe prostitucionin.<sup>21</sup> Të pesë strimoret kryesore në mbarë Kosovën janë anëtarë të këtij rrjeti dhe janë mbledhur për t'u takuar me përfaqësuesit e qeverisë qendrore me qëllim të avokimit për më shumë ndihmë financiare dhe teknike prej qeverisë.

RRKG-ja bashkëpunon me institucionet qeveritare kosovare dhe tashmë ka realizuar disa projekte të përbashkëta në fushën e DHKG-së. RRKG-ja ka takime të rregullta të përhershme nga dy herë në muaj me të gjithë anëtarët joqeveritarë. Për shembull, anëtarët e rrjetit udhëhoqën një fushatë kundër Dhunës kundër Grave në vitin 2001, e cila ishte organizuar në formë të shfaqjeve teatrore dhe të këngëve të popullarizuara të shkruara enkas për të informuar qytetarët lidhur me dhunën kundër grave brenda bashkësive të tyre, si dhe për mekanizmat për luftimin e kësaj dhune. Anëtarë të shumtë të komunitetit ishin angazhuar asokohe në fushatë, përfshirë edhe OJQ-të, policingë, avokatë e juristë, si dhe këngëtarë e shkrimtarë të famshëm. Në vitin 2004, anëtarët e RRKG-së, përfshirë Qendrën për Mbrojtjen e Grave dhe Fëmijëve, bashkëpunuan me Agjencionin Suedez të Zhvillimit Ndërkombëtar (SIDA), me Organizatën për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë (OSBE), me Shkollën e Shërbimit Policor të Kosovës, Organizatën Ndërkombëtare për Migrim (IOM), Rrjetin e Grave Serbe "Zora", Qendrën për Mbrojtjen e Viktimave dhe për Parandalimin e Trafikimit të Qenieve Njerëzore, si dhe me Forumin Kvinna për të organizuar fushatën "Lilja Forever", në kuadër të së cilës ishte përdorur një film nga regjisori suedez Lukas Moodysson për të ndërgjegjësuar politikanët, oficerët e policisë, organet e pushtetit, punëtorët socialë, gazetarët dhe opinionin lidhur me problemin e tregëtisë me njerëz për qëllime seksi dhe për trafikimin.<sup>22</sup>

Në fund, RRKG-ja është një rrjet joformal i OJQ-ve, disa prej të cilave i bashkojnë forcat për të vepruar në këtë fushë. Zakonisht bashkëpunimi i tyre lidhet me aktivitete specifike për ndërgjegjësimin e opinionit, të cilat shpesh përfshijnë vendimmarrësit, sistemin arsimor dhe organet policore. Pos kësaj, shtëpitë e sigurta bashkëpunojnë mes veti dhe jozyrtarisht me institucionet publike, siç janë policia dhe Zyra e Obmundspersonit, duke i drejtuar klientët në qendra që kanë hapësirë banimi dhe shërbime tjetra për to, e të tjera.

**3.3.2 A ka ndonjë mekanizëm sistemor për përfshirjen e OJQ-ve aktive në këtë fushë në hartimin, zhvillimin, zbatimin dhe vlerësimin e ligjeve e të politikave?**

Zyra për çështje Gjinore në kuadër të Zyrës së Kryeministrit, e cila është hapur në vitin 2005, është menduar si promovuese e barazisë gjinore në radhët e vendimmarrësve, përfshirë OJQ-të në hartimin, zhvillimin dhe në vlerësimin e implementimit të legjislacionit. Ky mekanizëm institucional nuk ka ende asnjë "mekanizëm sistemor" për përfshirjen e OJQ-ve në proceset ligjore.

<sup>21</sup> <http://www.womensnetwork.org/pdfs/Plani%20strategjik%20titujt%20AL.doc>

<sup>22</sup> Shih Raportin Vjetor të RRKG për vitin 2004, po ashtu në dispozicion në [www.womensnetwork.org](http://www.womensnetwork.org).

Përkundër mungesës së mekanizmave sistematikë për kyçjen e tyre, OJQ-të kosovare kanë ndërmarrë nisma për iniciimin dhe pjesëmarrjen në procesin e hartimit të ligjeve që kanë të bëjnë me barazinë gjinore. Për shembull, OJQ-të e grave kosovare kanë inicuar, organizuar dhe e kanë udhëhequr procesin e hartimit të Ligjit për Barazinë Gjinore dhe Planin Kombëtar për Realizimin e Barazisë Gjinore.

Qendra për Mbrojtjen e Grave dhe Fëmijëve (QMGF) dhe Norma kanë monitoruar procedimet juridike, me qëllim të konstatimit se sa zbatohen parimet në fushën e dhunës. Raporti Vjetor për vitin 2004 konstatonte se gjatë këtij viti kishte pasur “shkelje flagrante të të drejtave të viktimave/dëshmitarëve nëpër gjykata”.<sup>23</sup>

### **3.3.3 Ju lutemi të përmendni OJQ-të kryesore që merren me çështjet e DHKG-së në vendin tuaj. Cili është profili i tyre kryesor dhe burimi i financimit? Po ashtu jepni një listë të ekspertëve kryesorë.**

Qendra për Mbrojtjen e Grave dhe Fëmijëve (QMGF) ka selinë në Prishtinë, mirëpo ka shtrirje përmes degëve të veta nëpër tërë Kosovën. Ajo përqendrohet në çështjet që kanë të bëjnë me dhunën kundër grave (DHKG) dhe dhunë kundër fëmijëve. Ajo ofron shërbime shëndetësore, përkrahje psiko-sociale dhe këshilla, ndihmë juridike, dhe lidhje me strehimore. Kjo OJQ, pos tjerash, mbështetet financiarisht nga Kvinna till Kvinna (suedeze), UNIFEM-i, Organizata për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë (OSBE), UNICEF-i, Women’s AID, dhe Kinderberg.

Shoqata e Avokateve “Norma” është e vendosur në Prishtinë, por i ndihmon edhe klientët jashtë kryeqytetit. Norma ofron ndihmë juridike falas për gratë në “ lëndë civile” si shkurorëzime, banimi, e drejta pronësore, etj. Norma ka monitoruar punën e gjyqeve rajonale dhe të qendrave të punës sociale. Ajo ka marrë mbështetje financiare prej USAID-it përmes Foundationit për Iniciativa Demokratike (FDI) dhe prej UNICEF-it.

Shoqata e Grave është e vendosur në Gjakovë. Kryen hulumtime lidhur me DHKG-në, ofron falas ndihmë juridike, si dhe i drejton viktimat në vendstrehime. Bashkëpunon me Zyrën Amerikane në Prishtinë, me UNHCR-në, CARITAS-in, me Fondin për Zhvillimin Komunitar, me Fondacionin Kosovar për Shoqëri të Hapur, dhe KACI-n.

Qendra për Mirëqenien e Grave është e vendosur në Pejë. Kjo OJQ organizon aktivitete të ngritjes së vetëdijes për DHKG-në, u ofrojnë ndihmë psiko-sociale viktimave, si dhe i drejtojnë ato në vendstrehime. Ato bashkëpunojnë me Qendrën për Punë Sociale, me repartin gjinekologjik në Spitalin Rajonal të Pejës, policinë, UNMIK-un, OSBE-në dhe me OJQ të tjera nga Peja. Projektet e tyre financohen nga donatorë të ndryshëm ndërkombëtarë.

“Liria” në Gjiilan organizon aktivitete arsimore lidhur me DHKG-në, ofron përkrahje psiko-sociale për viktimat dhe i drejton ato në vendstrehime. Ato marrin pak përkrahje nga qeveria komunale, por pjesën më të madhe të fondeve e sigurojnë nga donatorët ndërkombëtarë.

Ka edhe shtëpi të tjera të sigurta që veprojnë si OJQ me mbështetje financiare nga donatorët ndërkombëtarë. Emrat dhe lokacionet e tyre nuk përmenden këtu për të mbrojtur anonimitetin e tyre.

<sup>23</sup> Qendra për Mbrojtje të Grave e të Fëmijëve, Raporti Vjetor 2004, përmbledhja Nr. 5, Prishtinë, 2005

Qendra për Mbrojtjen e Viktimave dhe për Parandalimin e Trafikimit të Qenieve Njerëzore (PVPT), është e vendosur në Prishtinë dhe bashkëpunon me OJQ të ndryshme vendore dhe ndërkombëtare, si dhe me policinë për të ndihmuar viktimat e trafikimit. Në punën e saj përkrahet nga donatorë ndërkombëtarë.

Organizata Ndërkombëtare për Migrim (IOM), është organizatë joqeveritare ndërkombëtare që vepron në Prishtinë, e cila siguron përkrahje për viktimat e trafikimit, përfshirë konsulencën psiko-sociale, sigurimin e vendstrehimit, dhe ndihmë për rivendosje ose kthim në vendet e veta. Kjo OJQ po ashtu merr pjesë në aktivitete me qëllim ndërgjegjësimi dhe edukimi. Financohet nga donatorë ndërkombëtarë.

Njeriu mund ta vërejtë se pos një ndihme të vogël për këto OJQ dhe shtëpi të sigurta që vjen nga qeveria kosovare, mbështetja më e madhe për punën e tyre vjen megjithatë nga burime dhe donatorë ndërkombëtarë.

**3.4 A ka plane të bashkërenditura veprimi në plan afatmesëm dhe afatgjatë për profesione të ndryshme në fushën e DHKG-së? Nëse po, cili profesion ka plane të këtilla, cilat janë masat dhe aktivitetet kryesore, afatet, bartësit e aktiviteteve, dhe buxheti i alokuar? A ka ndonjë raport progresi, raport vlerësues apo raport përcjellës të planit?**

Për momentin nuk ka asnjë plan afatmesëm apo afatgjatë të veprimit për profesionet në regjistrin e DHKG-së.

#### **4. NJËSITË SPECIALE NË ZYRAT PËR ZBATIMIN E LIGJIT**

**A ka njësi speciale (ose persona përgjegjës) në agjencionet për zbatimin e ligjit të cilat merren me DHKG-në? Nëse po, a janë të themeluara ato siç e parasheh ligji, në mënyrë sistematike e të organizuar apo në bazë vullnetare, si nisma eksperimentale? Cilat janë profesionet në të cilat veprojnë njësi / persona të tillë? Çfarë është përbërja (kualifikimet) dhe numri i personelit, a kërkojnë trajnim special për ta? A ka mundësi intervistimi me një oficerë femër nëse viktima kërkon një gjë të tillë; a janë ndërmarrë far hapash për të shtuar numrin e personelit të gjinisë femërore për këtë qëllim?**

Siç është thënë edhe më herët, në secilin stacion policor vepron nga një njësi speciale për dhunën familjare. Zakonisht këto njësi përbëhen nga dy oficerë policie (një mashkull dhe një femër) të cilët janë të trajnuar enkas për t'u marrë me situata të ndryshme të dhunshme në trajnimet e tyre në Shkollën e Shërbimit Policor të Kosovës. Siç është thënë, viktimat kanë të drejtë t'i flasin një policeje nëse duan. Shërbimi Policor i Kosovës ka ndërmarrë masa për të angazhuar femra në radhët e veta për këtë qëllim, si dhe për të krijuar më shumë barazi gjinore brenda forcës. Sipas Ligjit për Barazinë Gjinore, të gjitha profesionet duhet të kenë një kuotë të barazisë gjinore prej 40 % brenda forcës punëtore.

#### **5. SHËRBIMET NË DISPOZICION**

**5.1 A ka vendstrehime të veçanta për viktimat e dhunës? Nëse po, sa janë ato? Sa dhoma janë në dispozicion në vendin tuaj (shprehur në përqindje të popullatës)? Sa është numri i përgjithshëm i njerëzve në listën e pritjes (çfarë është raporti ndërmjet dhomave në dispozicion dhe kërkesave për vendosje)? Çfarë janë kushtet për vendosje (a janë falas, etj.)? Çfarë ndihme mund të ofrojnë ato (mjekësore, psikologjike, sociale, juridike, etj.)? A ofrojnë ndihmë të menjhershme në kuptimin e strehimit? Sa veta punojnë në to dhe cili**

**është kualifikimi i tyre? Ju lutem tregoni për mbulimin gjeografik të vendit tuaj nga këto vendstrehime, dhe mundësia e qasjes. A ka shërbime të tilla në dispozicion edhe për gra imigrante (nga vende të tjera)? Kush i udhëheqë këto dhe cilat janë burimet e financimit për to? A ka rregullore të brendshme të punës dhe të sjelljes; a përmbajnë këto rregullore dispozita përkitazi me udhëzimet për trajtimin e vitimave dhe punën e kordinuar të më shumë agjencioneve? A ka kushte të veçanta për punë me fëmijët? A ka ndonjë raport vlerësues dhe analizë për punën ose / edhe për rastet? Cilat janë konstatimet kryesore të këtyre raporteve (përfshirë rastet e përfunduara)?**

Në Kosovë janë pesë vendstrehime të mëdha dhe shumë vendstrehime të vogla, të fshehta në dispozicion të viktimave të dhunës. Megjithatë, të dhënat e sakta për vendndodhjen e tyre dhe informatat për kontakt nuk mund të publikohen për të ruajtur fshehtësinë e këtyre vendstrehimeve dhe sigurinë e klientëve që qëndrojnë në to. Megjithatë, disa të dhëna të përgjithshme janë në dispozicion.

Për momentin, në Kosovë veprojnë pesë vendstrehime, të cilat udhëhiqen nga organizata të ndryshme joqeveritare.

Vendstrehimet kryesore kanë doracakët e politikave që caktojnë udhëzimet për trajtimin e viktimave dhe mënyrën e bashkëpunimit me institucionet publike.. Nga një vendstrehim është i vendosur në secilin nga pesë regjionet e Kosovës. Të gjitha së bashku, këto vendstrehime mund të strehojnë përafërsisht 150 persona njëkohësisht. Megjithë mungesën e të dhënave të sakta, gjatë intervistave të gjithë theksonin se shpesh janë të detyruar t'i kthejnë njerëzit / klientët për shkak të mungesës së hapësirës ose të fondeve për t'i vendosur ata. Vendstrehimet janë pothuajse gjithnjë të mbushura deri në kapacitetin e tyre të plotë.<sup>24</sup>

Në shumicën e rasteve, vendstrehimet janë plotësisht pa pagesë, pasi që gati të gjithë klientët e tyre janë të papunë dhe rrjedhimisht nuk janë në gjendje të paguajnë për shërbimet e vendstrehimit. Megjithatë, në disa raste kur klientët qëndrojnë për periudha më të gjata kohore (për shembull, më shumë se gjashtë muaj), vendstrehimet e OJQ-ve i ndihmojnë klientët e vet të gjejnë punësim kështu që ata të mund të ndihmojnë në mbulimin e shpenzimeve të ushqimit, qëndrimit, etj.<sup>25</sup>

Vendstrehimet ofrojnë shërbime të ndryshme në të njëjtën kohë, përfshirë ndihmën mjekësore, rehabilitimin, këshillimin, përkrahjen juridike, mundësinë për të mësuar, e të tjera. Shumica prej tyre u ofrojnë mundësi fëmijëve të viktimave të dhunës të qëndrojnë në vendstrehim me nënat e veta; po ashtu bëhen marrëveshje me shkollat në afërsi në mënyrë që fëmijët të mund të vazhdojnë shkollimin gjatë qëndrimit në vendstrehim. Në disa raste, vendstrehimet sigurojnë transport të sigurt për nënat viktime të dhunës që t'i vizitojnë fëmijët e vet të cilët jetojnë jashtë vendstrehimit.

Gjithsej rreth 40 persona me profesione të ndryshme janë të punësuar në këto vendstrehime. Pos drejtorëve dhe menaxherëve që punojnë këtu, janë gjinekologë, mjekë të përgjithshëm, juristë, dhe profesionistë të tjerë të trajnuar që ofrojnë shërbimet e veta për klientët e strehuar në to.

Kur klientët janë gra nga vende të tjera, rastet i referohen IOM-it; kjo praktikohet sidomos në rastet e trafikimit ndërkombëtar. IOM-i, një organizatë joqeveritare ndërkombëtare, ka objektin e vet për vendstrehim ku ofron strehim, rehabilitim, si dhe riatdhesim në disa raste. Megjithatë, edhe shtëpitë e sigurta kosovare i kanë ndihmuar disa gra imigrante. Zakonisht, këtu përfshihen gra të cilat janë trafikuar ose kanë ardhur si refugjatë në pesë deri dhjetë vjetet e fundit nga vendet e rajonit. Shtëpitë e sigurta kosovare kanë disa shtretër të rezervuar vetëm për viktimat e trafikimit.

<sup>24</sup> Bazuar në intervistat e kryera nga Qendra Kosovare e Studimeve Gjinore në vjeshtë 2005.

<sup>25</sup> Po aty.

Këto OJQ / vendstrehime janë të financuara kryesisht nga organizata ndërkombëtare joqeveritare siç janë Kvinna Till Kvinna, Fondacioni Kosovar për Shoqëri të Hapur, OSBE-ja, KFOR-i, e të tjera.

**5.2 Sa vija emergjente telefonike janë të rezervuara për përdorim nga viktimat e DHKG-së në këtë vend? Cilat forma të dhunës i pranojnë dhe çfarë këshillash jepen (sociale, juridike, etj.)? A janë këto lidhje telefonike në dispozicion në tërë vendin dhe pa pagesë? Cilat janë orët e ditët e punës? Kush operon me to dhe cilat janë burimet për financimin e këtyre linjave emergjente telefonike? Sa veta janë të punësuar dhe cilat janë kualifikimet e personelit? A kërkohet aftësim special për personelin? A ka rregullore të brendshme të punës? Nëse po, sa linja emergjente kanë rregullore të tilla të brendshme; a përmbajnë ato rregullore dispozita që përcaktojnë udhëzimet për trajtimin e viktimave dhe punën e koordinuar të më shumë agjencioneve? A ka ndonjë raport (vlerësimi) dhe analiza lidhur me punën dhe thirrjet?**

Në Kosovë ka së paku një linjë S.O.S., e cila ofron dy lloje të shërbimeve: përkrahje emocionale dhe një linjë për rastet e trafikimit. Linja S.O.S. zakonisht mbahet nga studentë dhe nga psikologë të Universitetit të Prishtinës, të cilët janë të aftësuar nga Organizata Ndërkombëtare e Migrimit (IOM) në Kosovë. Kjo linjë punon falas 24 orë në ditë. Numri është (+377) (0)44 0 80 80. Pos këshillave personeli i udhëzon viktimat si ku dhe si mund të marrin ndihmë. Në raste kur viktima mund të orientohet për venin e ndodhjes, IOM-i e thërret policinë. Në një mënyrë, kjo linjë shërben edhe si ndërmejtuese në mes të policisë dhe viktimave.

Viktimat e dhunës mund të thërrasin policinë në çdo kohë. Numrat janë 044 112 dhe 044 92. Pas thirrjes, dhe me t'u konfirmuar rasti i dhunës, policia e dërgojnë viktimën në sektorin e dhunës familjare në kuadër të Drejtorisë për Krime Serioze. Secili vendstrehim ka një linjë të mbrojtur telefonike në të cilën viktimat e dhunës mund të thërrasin 24 orë në ditë.

Të pesë vendstrehimet kryesore të vendosura në mbarë Kosovën kanë edhe linja S.O.S. të cilat ofrohen gratis dhe 24 orë në ditë për të ofruar këshilla dhe informata për shërbimet në dispozicion. Këto nuk ofrojnë këshilla juridike në telefon dhe janë më të angazhuara për t'u marrë me situata emergjente. Kësisoj, dihet për ekzistimin e tetë linjave të 'nxehta'. Në të gjitha këto linja emergjente punojnë profesionistë të aftësuar të cilët merren me të gjitha format e dhunës. Ata u përmbahen rregulloreve të brendshme derisa u përgjigjen thirrjeve. Nuk ka ndonjë raport apo analizë për punën e tyre. Të gjitha financohen nga donatorë ndërkombëtarë, me përjashtim të linjave emergjente policore, të cilat financohen nga Buxheti i Kosovës.

**5.3 A ka ndonjë qendër për intervenim në rrethana krize? Nëse po, sa? Cilat forma të dhunës i mbulojnë ato (dhunën familjare, dhunimet, etj.)? A janë në dispozicion në tërë vendin dhe falas? A sigurojnë ato ndihmë të menjëhershme? Çfarë lloj ndihme mund të ofrojnë ato (mjekësore, psikologjike, sociale, juridike, etj.)? A ofrohen këto shërbime edhe për grate imigrante? Si financohen këto shërbime dhe kush punon në to? Sa është numri i personelit dhe cilat janë kualifikimet e tyre? A kërkohet kualifikim i posaçëm për personelin? A ka ndonjë rregullore të brendshme pune? Nëse po, sa qendra të këtilla kanë rregullore të brendshme të punës; a përmbajnë ato dispozita që përcaktojnë udhëzimet për trajtimin e viktimave dhe për punën e koordinuar të më shumë agjencioneve? A ka ndonjë raport (vlerësues) dhe analiza për punën dhe rastet, cilat janë konstatimet kryesore të këtyre raporteve (përfshirë rastet e përpunuara)? A ka kushte të veçanta për trajtimin e fëmijëve?**

Qendra për Mbrojtjen e Grave dhe Fëmijëve ka dy qendra të krizave të cilat shërbejnë për vendosjen emergjente të viktimave. Një vendstrehim është i rezervuar për viktimat e dhunës familjare dhe një për viktimat e trafikimit dhe të prostitucionit të imponuar. “Këto vendstrehime janë të rezervuara vetëm për viktimat të cilave u rrezikohet jeta, dhe qëndrimi maksimal këtu mund të jetë tri javë”.<sup>26</sup> Janë në dispozicion të viktimave nga mbarë Kosova, ndërsa viktimat drejtohen për këtu nga vende të ndryshme të Kosovës.

Shumica e vendstrehimeve të tjera nëpër tërë Kosovën gjithashtu ofrojnë strehim emergjent për viktimat e dhunës familjare, trafikimit, dhe dhunës. Megjithatë, ndonjëherë atyre u është dashur të refuzojnë klientët për shkak të mungesës së hapësirës. Të gjitha vendstrehimet dhe shërbimet emergjente jepen falas. Këto janë të njëjtat vendstrehime që u përmendën më lartë dhe, rrjedhimisht, edhe shërbimet e ofruara prej tyre, rregulloret e punës, shërbimet për gratë imigrante, personeli, dhe shërbimet e ofruara për fëmijët janë të njëjta sikur ato të përmendura më lartë.

**5.4 A ka ndonjë program trajtimi për shkaktarët e dhunës? A janë këto në dispozicion në mënyrë sistematike dhe të rregulluar, e jo në bazë projekti dhe me nisma të kohëpaskohshme? A marrin pjesë kundërvajtësit në këto programe në mënyrë të detyrueshme apo vullnetare, si alternativë për dënimin apo si masë shtesë? Sa kundërvajtës kanë marrë pjesë gjatë vitit të kaluar? Sa zgjatë programi dhe cila është përmbajtja e tij? A janë këto programe në dispozicion në tërë vendin? Kush i organizon këto dhe cilat janë burimet e financimit? A ka ndonjë mekanizëm ose raport për vlerësimin e efektivitetit?**

Në Kosovë tani për tani nuk ka ndonjë program për trajtimin e kundërvajtësve.

**5.5 A ka shërbime dhe mundësi të tjera (grupet e vetëorganizuara për ndihmë etj.) për mbështetjen e viktimave? Nëse po, ju lutem prezentoni shkurtimisht ato.**

Në Kosovë nuk ka shumë grupe të tilla zyrtare. **Gjithashtu, nuk ka grupe të vetëorganizuara për ndihmë** që ofrojnë shërbime për viktimat. Megjithatë, të pesë vendstrehimet e përmendura më herët ofrojnë aktivitete sociale dhe përkrahje joformale për viktimat e strehuara në to. Viktimat e dhunës të strehuara në këto strehimore shpesh kanë mundësinë të marrin pjesë në aktivitete të ndryshme sociale, si kurse në kompjuterë, qepje dhe zierje, të cilat shërbejnë si mekanizma të përkrahjes sociale. Ato marrin pjesë në aktivitete të përbashkëta shoqërore, përmes të cilave krijohet një atmosferë përkrahjeje joformale për njëra tjetrën. Në raste të caktuara, disa vendstrehime u ofrojnë klientëve mundësi shkollimi dhe i ndihmojnë për të kërkuar punë.

## **6. ARSIMI DHE AFTËSIMI**

**Shënim: informatat e mbledhura duhet të mbulojnë të gjitha format e arsimit dhe aftësimin, si dhe të gjitha profesionet relevante për zbatimin e ligjit.**

**6.1 A ka njësi dhe tema speciale për DHKG-në në planprogramet shkollore të shkollave fillore dhe të mesme; a ka përmbajtje për format e ndryshme të DHKG-së dhe për paragjykimet dhe rolet e paracaktuara për gjinitë (si dhe për diskriminimin gjinor në**

Koordinatori i Zyrës për të Drejtat e Njeriut në Ministrinë e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë, Znj. Lulavere Kadriu tha se në vitin 2005, Ministria e Arsimit, Shkencës dhe

<sup>26</sup> Qendra për Mbrojtjen e Grave dhe Fëmijëve, Raporti Vjetor 2004, Prishtinë 2005



Teknologjisë, në bashkëpunim me UNICEF-in, ka filluar një projekt pilot për futjen e një lënde të re në planprogramin e klasës së tetë të shkollës së mesme të ulët. Lënda “Shkathësitë jetësore” përfshinë tema të ndryshme nga fusha e çështjeve gjinore, siç janë dhuna në përgjithësi, dhuna familjare, trafikimi i qenieve njerëzore, stereotipet gjinore, seksualiteti, e të tjera”.<sup>27</sup> Projekti pilot është zhvilluar në 30 shkolla fillore në Kosovë. Programi do të vlerësohet në fund të vitit shkollor nga ministria. Për këtë qëllim do të përdoret një pyetësor për mësimdhënësit e për nxënësit. Në bazë të konstatimeve do të sjellet edhe vendimi nëse do të vazhdohet programi ose jo. Për mësimdhënësit e këtij programi është organizuar një program aftësues nëntë ditor. UNICEF-i e ka financuar tërë projektin.

OJQ të ndryshme kanë ofruar arsimim paksa më joformal. Për shembull, si pjesë e fushatës së sipërpërmendur “Lilja Forever” (e cila ndërtohet mbi një film për një vajzë adoleshente që bie viktimë e trafikimit), OJQ-të vendore ishin lidhur me shkollat në komunat e tyre për t’ua shfaqur filmin prindërve dhe nxënësve (ndonjëherë edhe ndaras) ashtu që në fund u zhvilluan diskutime shumë të hapta për këtë çështje. OJQ të ndryshme kohëpaskohe porosisin shpallje radio dhe televizive në shkallë vendore dhe kombëtare me informata për DHKG-në, të drejtat sipas ligjit dhe për vendet ku mund të merret ndihmë.

**6.2 A ka ndonjë program të detyrueshëm (në universitete, shkolla profesionale, etj.) për profesionistët e ardhshëm, përfshirë policinë, prokurorët, gjykatësit, personelin për mbrojtje sociale, shëndetësore, personelin për mbrojtje të fëmijëve dhe të familjes, dhe për mësimdhënësit lidhur me DHKG-në, për format e ndryshme të manifestimit të saj, dhe për rolet stereotipe për gjinitë (si dhe për diskriminimin gjinor në përgjithësi)? Nëse po, cilat profesione kanë përmbytje të tilla në planprogramet e veta? Sa zgjasin (numri i orëve dhe ditëve gjatë një viti) këto programe, dhe cila është përmbytja e tyre? Kush i ofron këto trajnime dhe cilat janë burimet e financimit?**

Të gjithë policët e Shërbimit Policor të Kosovës duhet të vijnë kurse trajnime ku ata mësojnë të merren me lloje të ndryshme të dhunës në mënyrë profesionale, përfshirë dhunën familjare, dhunën fizike, dhunën seksuale, dhe trafikimin. Ata i vijnë këto programe aftësimi në Shkollën e Shërbimit Policor të Kosovës në Vushtrri para se të bëhen policë. Shkolla e policisë financohet kryesisht nga donacione të qeverive të ndryshme të huaja përmes OSBE-së.

Në profesionet e tjera, aftësimi lidhur me DHKG-në dhe çështjet gjinore është më sporadic. Dhe pos në rastin e policisë, këto programet e tjera të trajnimit nuk janë të obligueshme? Në vitin 2002, Fondacioni Kosovar për Shoqëri të Hapur e ka përkrahur një program në të cilin OJQ-të e angazhuara në aktivitete të lidhura me dhunën familjare i kanë aftësuar policët, gjyqtarët dhe gazetarët në çështjet lidhur me DHKG-në. Ky ishte një program tremujor i aftësimit në katër komuna dhe secili prej tyre ka zgjatur nga dy ditë.

Në vitin 2005, Ministria e Arsimit ka organizuar një program nëntëditor aftësimi për mësimdhënësit në projektin e sipërpërmendur pilot për lëndën e re “Shkathësitë jetësore”. Ministria e Arsimit i ka aftësuar 210 mësimdhënësit në përmbytje të ndryshme, përfshirë përpjekjet kundër trafikimit të qenieve njerëzore. Pas kësaj, mësimdhënësit e kanë përfshirë trafikimin si një nga temat e planprogrameve të veta. Kësisoj, mësimdhënësit kanë krijuar hapësirë për debate për trafikimin dhe dhunën kundër grave dhe fëmijëve në lëndët e ndryshme që i ligjërojnë në shkollë.

**6.3 A ka ndonjë program tjetër trajnime për profesionistët e ardhshëm në temat e sipërpërmendura? Nëse po, çfarë është (ishte) numri i pjesëmarrësve, kohëzgjatja dhe**

<sup>27</sup> Intervistë personale me Koordinatorin e Zyrës për të Drejtat e Njeriut në Ministrinë e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë, Znj. Lulevere Kadriu, më 31.01.2006.

**përmbajtja? Kush ishin organizatorët dhe cilat janë burimet e financimit? Sa shpesh organizohen këto programe (në vazhdimësi apo kohë pas kohe) dhe për sa njerëz?**

Megjithëse nuk ka programe zyrtare aftësuese për profesionistët e tjerë (pos atyre të përmendur më lartë), ekzistojnë një numër i madh i trajnimeve që ofrohen nga OJQ vendore e ndërkombëtare në lidhje me gjinitë e ndonjëherë edhe me DHKG-në. Pasi që programet aftësuese në fushën e gjinisë kanë qenë disi “temë e nxehtë” në mesin e komunitetit ndërkombëtar të donatorëve në Kosovë, është e pamundur të përshkruhen këtu gjithë ato programe, numri i pjesëmarrësve në to, kohëzgjatja dhe përmbajtja e tyre. Shkurt, pothuajse të gjitha këto programe janë implementuar nga OJQ-të vendore me përkrahje financiare prej donatorëve ndërkombëtarë dhe zhvilloheshin në mënyrë sporadike. Në Kosovë ka një numër të “trajnesve gjinorë” të cilët janë të përfshirë në programe të tilla; shumica prej tyre pretendojnë të kenë aftësuar me qindra persona në fushën e gjinive, në trajnime që zakonisht përfshijnë rolet e gjinive, stereotipet, dhe një diskutim për mënyrat si mund të lëvizet në drejtim të barazisë më të madhe gjinore në shoqëri.

Pos kësaj, qeveria ka filluar me përpjekjet e para që t’i aftësojë personelin e vet në trajnime nga fusha e çështjeve gjinore. Në vitin 2004 Universiteti i Prishtinës për herë të parë ka futur kurset gjinore në programin e studimeve të Departamentit të Sociologjisë.

**6.6 A është e përfshirë perspektiva gjinore (çështja e barazisë gjinore) në programet arsimore të të drejtave të njeriut?**

Nuk ka programe të tjera arsimore që merren ekskluzivisht me të drejtat e njeriut. Megjithatë, të gjitha diskutimet në fushën e të drejtave të njeriut, zakonisht përmbajnë një pikëvështrim gjinor. Në ligjëratat dhe tryezat e rumbullakëta të organizuara nga OJQ-të, siç është Këshilli për Mbrotjtjen e të Drejtave dhe të Lirive të Njeriut, diskutohen edhe çështjet që kanë të bëjnë me gjinitë.

**6.7 A ka programe arsimore për seksin në vendin tuaj, ashtu që të jenë pjesë e planprogrameve shkollore si në shkollat fillore ashtu edhe në ato të mesme? A ka programe të tjera në këtë temë? Nëse po, a i japin këto programe rëndësi të veçantë barazisë gjinore dhe respektit të ndërsjellë? Kush i udhëheqë këto programe dhe cilat janë burimet e financimit?**

Programi i sipërpërmendur pilot “Shkathhtësitë Jetësore”, i cili është futur në klasën e tetë të shkollës së mesme të ulët, përmban tri module të lidhura me edukatën seksuale: “Çka është seksualiteti”, “Si zvogëlohen rreziqet seksuale”, dhe “Çka është trafikimi i qenieve njerëzore”. Nisma për këtë program ka rrjedhur prej Ministrisë së Arsimit, ndërkaq financimin e tij gjatë fazës pilot e bën UNICEF-i.

**6.8 A ka ndonjë program i arsimit të lartë që merret me çështjet e barazisë (gjinore)? Nëse po, a e përfshijnë ato çështjen e dhunës kundër grave? Kush i udhëheqë këto programe dhe cilat janë burimet e financimit?**

Departamenti i Sociologjisë të Fakultetit të Filozofisë në Universitetin e Prishtinës organizon një kurs për “Studimet gjinore”, i cili e trajton çështjen e dhunës kundër grave. Po ky departament ofron edhe kursin “Patologji sociale” në kuadër të të cilit trajtohen dhuna familjare dhe dhuna kundër grave.

## **7. MEDIAT**

### **7.1 A ka dispozita në ligjin për mediat lidhur me DHKG-në dhe për portretimin e femrave? Nëse po, ju lutemi t'i pasqyroni shkurtimisht.**

Sipas Komisarit të Përkohshëm të Mediave në Kosovë, Z. Robert Xhillet (Robert Gillette),<sup>28</sup> "Nuk ka ndonjë rregullore apo ligj i cili do të rregullonte pasqyrimin e dhunës kundër grave".<sup>29</sup> Pos Kodit të Përkohshëm Penal të Lpspvës, o cili zbatohet edhe për mediat, nuk ka ndonjë ligj tjetër të posaçëm që do të rregullonte këtë çështje.

### **7.2 A ka ndonjë udhëzim apo rregullore të brendshme për profesionistët e mediave, i cili do të merrte parasysh çështjen e DHKG-së dhe do të synonte promovimin e imazhit të femrave dhe meshkujve jashtë skemave dhe klisheve ekzistuese, si dhe do të shmangte programet që lidhin seksin dhe dhunën? Nëse po, ju lutemi t'i paraqitni shkurtimisht dispozitat kryesore.**

Në Kosovë nuk ka udhëzime, rregullore të brendshme apo urdhëresa për mediat Kosovare që do të përcaktonin këtë fushë. Kodi për sjelljen e mediave është mjaftë i përgjithësuar dhe nuk përfshinë ndonjë referencë specifike për gjininë.

### **7.3 A ka ndonjë organizatë (shtetërore ose joshtetërore) për monitorimin e mediave në vendin tuaj? Nëse po, cilat janë autorizimet e tyre dhe aktivitetet përkritazi me DHKG-në, seksualizmin dhe pasqyrimin të klisheizuar të femrave? A ka ndonjë rast relevant i DHKG-së në punën e tyre?**

Komisiari i Përkohshëm i Mediave në Kosovë<sup>30</sup> është institucioni i vetëm që merret me monitorimin e mediave në Kosovë. Ky është i autorizuar të ndërmarrë masa financiare dhe disiplinore kundër mediave. Në rastet e keqpërfaqësimit të grupeve të minoriteteve etnike. Megjithatë, ky nuk ka politikë të veçantë për trajtimin e dhunës kundër grave në media. Janë disa OJQ që në mënyrë periodike e kanë monitoruar pasqyrimin e grave në media dhe që kanë publikuar raporte dhe copëza me konstatimet e veta. Prapëseprapë asnjë nga këto nuk kanë autoritet të ndikojnë mbi mediat dhe, vetëm një numër i vogël prej tyre kanë ndërmarrë përpjekje serioze për të kërkuar ndryshime në pasqyrimin e grave në media.

### **7.4 A ka ndonjë program trajnimi për profesionistët e mediave në fushën e DHKG-së (dhe në qëllimin për të promovuar paraqitjen e klisheizuar të grave dhe burrave dhe për shmangien e programeve që i lidhin dhunën me seksin)? A jepen ato në kuadër të arsimit formal (në shkollat e gazetarisë), si kurse të detyrueshme apo në bazë projekti dhe në mënyrë vullnetare? Sa është numri i pjesëmarrësve, kohëzgjatja dhe përmbajtja e këtyre programeve? Kush janë organizatorët dhe cilat janë burimet e financimit?**

<sup>28</sup> Robert Gillette ishte emëruar Komisar i Përkohshëm për Media nga Përfaqësuesi Special i Sekretarit të Përgjithshëm i UNMIK-ut në korrik 2003.

<sup>29</sup> Intervistë telefonike me Komisarin e Përkohshëm të Mediave në Kosovë, bërë më 14.02.2006.

<sup>30</sup> "KPM-ja mëton të promovojë zhvillimin e një tregu të qëndrueshëm të mediave, i cili do t'i shërbente të gjithë njerëzit në Kosovë; të inkurajojë profesionalizmin në radhët e gazetarëve, menaxherëve dhe pronarëve të mediave në Kosovë; të mbrojë lirinë e shprehjes, diversitetin e mendimit, qasjen në informata për gazetarët dhe publikun, si dhe interesimin e shfrytëzuesve të shërbimeve të mediave e të operatorëve në përputhje me ligjin". Marrë nga: <http://www.imc-ko.org/>.

Një numër i gazetarëve profesionistë në Kosovë kanë deklaruar se nuk e dinë nëse është organizuar ndonjë trajnim i gazetarëve në Kosovë, i cili do të kishte lidhje me stereotipet dhe paragjykimet gjinore. Disa media pretendojnë se i kanë aftësuar gazetarët e vet në fushën e çështjeve gjinore, por nuk kanë bërë diçka që më për së afërmi lidhet me DHKG-në.

**7.5 A marrin pjesë mediat në fushatat e informimit për të alarmuar opinionin publik për dhunën kundër grave, përfshirë edhe llojet e ndryshme të DHKG-së dhe pasojat e tyre për viktimat? Nëse po, cilat media (të shkruara, elektronike, etj.) janë të kyçura, dhe në cilat mënyra kontribuojnë ato?**

Shumica e mediave në nivel qendror dhe vendor e kanë përkrahur një pjesë të madhe të këtyre fushatave për të senzibilizuar opinionin publik lidhur me dhunën kundër grave; kjo zakonisht bëhet në bashkëveprim me OJQ-të aktive në këtë fushë. Çdo vit, në Ditën Ndërkombëtare kundër Dhunës kundër Grave më 25 nëntor, të tri stacionet televizive kombëtare (RTK, RTV21, dhe KTV), radio stacionet në Kosovë, si dhe shumë stacione radio e televizive vendore transmetojnë programe dhe spote televizive kundër dhunës kundër grave.

Gjatë fushatës “Unë vendosi për vetën time”, e realizuar nga IOM-i, qeveria finlandeze, OJQ-ja INTEGRA dhe Zyra për Qeverisje të Mirë në shkurt të vitit 2006, mediat kosovare transmetuan spote të ndryshme muzikore kundër qenieve njerëzore. IOM-i kohë pas kohe i përkrahë spotet kundër DHKG-së dhe trafikimit në media të ndryshme.

Rrjeti Kosovar i Grave dhe anëtarët e tij pothuajse çdo herë i përfshijnë mediat e nivelit vendor dhe qendror në fushatat e veta. Fushata e sipërpërmendur “Kundër Dhunës kundër Grave” e vitit 2001 (e përkrahur nga Fondacioni Kosovar për Shoqëri të Hapur dhe nga donatorë të tjerë) dhe “Dini të drejtat e juaja” e vitit 2004 – 2005 kishin angazhuar RTV 21 në transmetimin e shfaqjes dhe të pjesëve muzikore në video-incizim që kishin për temë dhunën kundër grave. Kjo ishte përkrahur nga UNIFEM-i.

**7.6 A ka ndonjë analizë për praninë dhe mënyrën e paraqitjes së DHKG-së ose të formave të saj të ndryshme në media? Cili ka qenë burimi i financimit të analizës: buxhet vetanak, financim qeveritar apo financim nga burime të tjera? Cilat janë konstatimet kryesore?**

Qendra Kosovare për Studime Gjinore (QKSGJ) ka monitoruar mediat dhe ka mbledhur copëza të shtypit ditor në vitin 2003. Projekti ishte financuar nga Fondacioni Kosovar për Shoqëri të Hapur. Gjashtë gazeta ditore kosovare ishin monitoruar asokohe. QKSGJ ka rekomanduar që gazetat ditore të reflektojnë më shumë lidhur me dhunën kundër grave dhe të përfshijnë më shumë analiza informative. QKSGJ-ja i ka anketuar mediat në tërë Kosovën me disa pyetje lidhur me DHKG-në; konstatimet botohen në fund të vitit 2006.

Mbase studimi më përmbledhës i përqendruar plotësisht në temën e DHKG-së në Kosovë ishte publikuar nga UNIFEM-i Kosovë në tetor 2000 me titullin “Nuk ka vend të sigurtë: një vlerësim për Dhunën kundër Grave në Kosovë”, e mbështetur nga Departamenti Britanik për Zhvillim Ndërkombëtar (DFID).

Disa OJQ të tjera po ashtu kanë bërë monitorim të mediave, mirëpo, raportet e tyre kryesisht përbëheshin nga copëza gazetash dhe nuk ofronin konkluzione apo rekomandime. Shumica ishin mbështetur nga donatorë ndërkombëtarë.

**8. AKTIVITETE PËR NGRITJEN E VETËDIJES**

**8.1 A ka pasur ndonjë fushatë kundër DHKG-së? Nëse po, sa janë organizuar në pesë vitet e fundit? Cilat forma të dhunës i kanë mbuluar ato? A kishin shtrirje ato në tërë Kosovën? Kush ishin organizatorët dhe cilat ishin burimet e financimit? Cili ishte mesazhi**

**kryesor. grupet përfituese (viktimat, opinioni publik, shkaktarët e dhunës, etj.)? Cila ishte kohëzgjatja dhe shpeshtësia? A ka pasur veprime përcjellëse, matje të efektivitetit?**

Gjatë pesë vjetëve të fundit, në Kosovë janë zhvilluar dhe zbatuar fushata të shumta të dhunës kundër grave. Megjithatë, është e vështirë të jepet një numër i saktë i të gjitha fushatave të zhvilluara. Shumë OJQ të grave çdo vit kanë organizuar fushata në lidhje me Ditën Ndërkombëtare kundër Dhunës kundër Grave (25 nëntor), ditën e grave 8 marsin, dhe Javën kundër Trafikimit të Qenieve Njerëzore. Për shembull, Qendra për Mirëqenien e Grave në Pejë, e mbështetur nga mediat, policia, nxënës vullnetarë dhe nga komuniteti, çdo vit më 25 nëntor organizojnë një ditë të shiritit të bardhë.

OJQ-të vendore të grave kanë organizuar fushata të shkurta në qytete të ndryshme në mbarë Kosovën. Fushata më të mëdha organizohen shpesh në Prishtinë dhe pastaj barten në qytete të tjera. Në shumicën e rasteve, këto ngjarje organizohen me ndihmë teknike dhe financiare nga organizata ndërkombëtare të donatorëve që veprojnë në Kosovë.

Në vitin 2001, RRRG-ja – një rrjet i përbërë prej më se 77 OJQ nga mbarë Kosova – kanë bashkërenditur përpjekje në organizimin e “Fushatës kundër Dhunës kundër Grave”. Kjo fushatë përdori artin dhe teatrin për të shtuar shkallën e informimit tek opinioni publik lidhur me problemin e dhunës kundër grave, përfshirë dhunën familjare, dhunimin në kohë lufte, dhunimin në marrëdhëniet e zakonshme, trafikimin, dhe prostitucionin. Aktivistet kosovare i kishin komponuar tetë këngë dhe kishin shkruar gjashtë monologje të bazuara në tregime të vërteta, të cilat ishin interpretuar nga aktorë dhe këngëtarë të popullarizuar nëpër mbarë Kosovën dhe ishin shfaqur në media. Duke bërë ngritjen e vetëdijes, RRRG-ja është orvatur të frenojë rritjen e trafikimit të grave, të ndihmojë gratë të ikin nga situatat e dhunshme, si dhe të shpjegojë shërbimet që janë në dispozicion për viktimat e dhunës. Në mënyrë që të mos përfundojnë në tragjedi, këto pjesë të fushatës i kanë fuqizuar “viktimat” për t’i tejkuluar paragjykimet shoqërore, të kërkojnë dhe të gjejnë mbështetje te njerëzit e te institucionet, si dhe të shndërrohen në “persona që mund të mbijetojnë”. Kjo fushatë rezultoi me numër të shtuar të raporteve policore kundër dhunës dhe me një rënie të shqetësimit në vend të punës. RRRG-ja organizoi një fushatë të ngjajshme në vitin 2005 me titull “Dini të drejtat tuaja” që kishte për qëllim ngritjen e vetëdijes së popullatës për të drejtat e tyre juridike siç parashiheshin në mekanizma të ndryshëm për barazinë gjinore.<sup>31</sup> Kjo fushatë përfshinte edhe një video incizim muzikor shumë të popullarizuar për dhunën kundër grave. Ajo ishte mbështetur nga UNIFEM-i. Të dyja këto fushata synonin të bartnin mesazhin te publiku i gjerë dhe zgjatën për muaj të tërë.

Qendra për Mbrojtjen e Grave dhe Fëmijëve (QMGF) zbatoi një sërë aktivitetesh të përqendruara kryesisht në ngritjen e vetëdijes së qytetarëve lidhur me dhunën kundër grave, me theks të posaçëm në dhunën familjare. Në vitin 2003, QMGF-ja organizoi seminarë të ndryshëm kundër dhunës kundër grave, ndërkaq përfituesit kryesorë ishin oficerët e policisë dhe nxënësit e shkollave të mesme.<sup>32</sup> Në vitin 2001, QMGF-ja e organizoi fushatën “Dhunimi si armë lufte”, që u organizua me qëllim të njohjes së të drejtave të femrave dhe për përdorimin e tyre si mjet për të luftuar dhunën që ushtrohet brenda dhe jashtë familjes.<sup>33</sup>

Në vitin 2004, një bashkim i organizatave vendore dhe ndërkombëtare e koordinuan fushatën “Lilja Forever” (Lilja përgjithshmonë) që mëtonte ngritjen e vetëdijes për trafikimin e grave dhe vajzave. Fushata ishte bazuar në filmin “Lilja përgjithshmonë” të regjisorit suedez Lukas Moodysson, ku përshkruhet jeta dhe përjetimet e një gruaje të re nga Evropa qendrore dhe

<sup>31</sup> “Raporti i Shoqërisë Civile Kosovare për Kombet e Bashkuara lidhur me Dhunën Kundër Grave në Kosovë”, përgaditur nga Nicole Farnsworth, Ilire Rizvanolli, dhe Lauren Bean, për Qendrën Kosovare për Studime Gjinore, Prishtinë. mund të merret në <http://kgscenter.org/program.php?id=26&lng=EN>. Për më shumë informata, shih edhe në [www.womensnetwork.org](http://www.womensnetwork.org).

<sup>32</sup> Qendra për Mbrojtjen e Grave dhe Fëmijëve, Raporti Vjetor 2003, Nr. 4, Prishtinë, 2004

<sup>33</sup> Qendra për Mbrojtjen e Grave dhe Fëmijëve, Raporti Vjetor 2001, Prishtinë, 2002

lindore e cila u bë viktimë e trafikimit për qëllime seks. Filmi ishte shfaqur anembanë Kosovës dhe projekcioni ishte pasuar me diskutime. Fushata arriti të ndërjegjësojë politikanët, policët, autoritetet, punëtorët socialë, gazetarët dhe opinionin publik lidhur me problemin e tregtisë për seks.<sup>34</sup>

## **8.2 A ka pasur ndonjë konferencë në shkallë kombëtare apo projekte të tjera për ngritjen e vetëdijes përfshirë edhe programet parandaluese në fushën e DHKG-së, që nga viti 2003?**

Pos fushatave dhe programeve të sipërpërmendura për ngritjen e vetëdijes, më 30 qershor, 1 dhe 2 korrik 2002, QMGF-ja organizoi në Prishtinë një konferencë “Dhuna Kundër Grave dhe Fëmijëve në Kosovë”, e cila trajtonte format kryesore të dhunës që i përjetojnë gratë dhe fëmijët në jetën e tyre të përditshme. Në kuadër të kësaj ngjarjeje u diskutuan edhe mënyrat për të tejkaluar këto forma të dhunës.

Në vitin 2003, QMGF-ja ishte bashkëorganizatore e një konference kundër trafikimit të qenieve njerëzore me ç’rast u analizuan dhe u diskutuan çështje të ndryshme, përfshirë informatat për trafikimin e qenieve njerëzore në Kosovë, shkaqet, pasojat dhe mënyrat për luftimin e tyre.

Shumë organizata joqeveritare, ndërkombëtare dhe vendore morën pjesë në konferencën ndërkombëtare, e organizuar në pjesë të ndryshme të botës.

## **8.3 A kanë viktimat në dispozicion broshura/pako informative për të drejtat e tyre, për intervenimin ligjor dhe policor, si dhe për shërbimet ku mund të kërkojnë ndihmë? Cilat forma të dhunës i mbulojnë ato dhe cila është përmbajtja e tyre? Në cilën gjuhë janë shkruar, kush i ofron dhe kush i financon? Sa kopje janë përgaditur për shpërndarje? Në çfarë intervalesh shpërndahen ato (rregullisht apo vetëm sipas rastit)? A janë në dispozicion këto materiale në tërë vendin? Në cilat vende dhe autoritete për zbatimin e ligjit mund të gjenden këto materiale?**

Shumë OJQ që kishin organizuar programe ose aktivitete kundër dhunës kundër grave kanë publikuar pako informative apo broshura lidhur me këtë çështje të rëndësishme. Broshurat dhe pakot përmbajnë informata lidhur me zyrat që merren me këtë çështje, numrat e telefonave që mund të thërrasin viktimat, si dhe informacione për vendstrehimet. Disa broshura përmbajnë edhe informacione ndërjegjësimi duke dhënë shifra për gratë e trafikuar dhe për gratë që kishin përjetuar dhunën. Zakonisht, informatat publikohen në tri gjuhë (shqip, anglisht, serbisht). Megjithatë, ka raste kur broshurat botohen vetëm në gjuhën shqipe dhe serbe. Broshurat janë shpërndarë nëpër tërë Kosovën (ashtu që broshurat në gjuhën serbe janë shpërndarë në zonat e banuara nga komuniteti serb).

Një libërth shumë i dobishëm është botuar në tri gjuhë nga Grupi për Analiza dhe Studime të Barazisë Gjinore në vitin 2005 i quajtur “Dini të drejtat tuaja”. Ajo përmban informata të kuptueshme për ligje të ndryshme të rëndësishme për barazinë gjinore dhe për mënyrat se si qytetarët mund të sigurojnë qasje në të drejtat e parapara në ato ligje. Aty ka informacione për këto ligje: CEDAW, Barazia Gjinore, Martesa dhe Familja, Dhuna Familjare, Puna dhe Barazia Gjinore (përfshirë ngacmimin seksual), dhe diskriminimi (gjinor). 1000 kopje ishin përgaditur për shpërndarje nëpër institucione të ndryshme dhe nëpër OJQ-të në lokalitete të ndryshme anembanë Kosovës.

<sup>34</sup> “Raporti i Shoqërisë Civile Kosovare për Kombet e Bashkuara lidhur me Dhunën kundër Grave në Kosovë”, përgaditur nga Nicole Farnsworth, Ilire Rizvanolli, dhe Lauren Bean, për Qendren Kosovare për Studime Gjinore, Prishtinë. Mund të shkarkohet nga <http://kgscenter.org/program.php?id=26&lng=EN>. Shih po ashtu edhe Raportin Vjetor të RRRK në [www.womensnetwork.org](http://www.womensnetwork.org).

Shoqata e Avokateve Norma po ashtu ka botuar një udhëzim të titulluar “Kujt t’i drejtohem?” me informata të shumëta për viktimat, përfshirë edhe vendet ku mund të përfitonin nga shërbime të ndryshme, telefonat për thirrje emergjente, etj.

## **9. HULUMTIME DHE ANKETA**

**9.1 A ka pasur ndonjë hulumtim apo anketë në pesë vjetët e kaluara në vendin tuaj për të gjitha apo për disa forma të DHKG-së, përfshirë shpeshhtësinë, koston, shkaqet, pasojat e DHKG-së, si dhe vlerësimin e efikasitetit të judikaturës dhe të sistemit gjyqësor? (Kufizimi kohor nuk zbatohet nëse ka pasur vetëm një lloj hulumtimi). Kush ishin organizatorët, hulumtuesit dhe cili ishte burimi i financimit?**

Qendra për Mbrojtjen e Grave dhe Fëmijëve regjistron të dhënat për të gjitha rastet që kalojnë nëpër këtë qendër, përfshirë edhe format e dhunës që i përjetojnë këto gra. Konstatimet e përgjithshme publikohen çdo vit në Raportin e tyre Vjetor, i cili është në dispozicion në web-faqen e tyre.<sup>35</sup> QMGF-ja përkrahet nga donatorë ndërkombëtarë si Kvinna till Kvinna dhe OSBE për publikimin e këtij raporti.

Në prill të vitit 2005, Organizata Ndërkombëtare për Migrim (IOM) ka kryer një hulumtim për “Qëndrimet dhe besimet për trafikimin e njerëzve në Kosovë”. Në këtë hulumtim ishin anketuar 900 njerëz anembanë Kosovës. Njësia Kundër-Trafikim e IOM-it për Kosovë po ashtu e publikon një raport monitorues për situatën e trafikimit në Kosovë në mënyrë periodike çdo dy-tri vjet, ku boton të dhëna për shpeshhtësinë e trafikimit të grave në Kosovë, për aspektet demografike të të trafikuarave, vendet e prejardhjes, etj.

Në anën tjetër, Emnesti Interneshnëll, në maj 2004, ka publikuar një analizë të thelluar me raste studimi në çështjen e trafikimit në Kosovë të titulluar “A domethënë kjo se unë kam të drejta: mbrojtja e të drejtave të grave e të vajzave të trafikuar për prostitucion të detyruar në Kosovë”.<sup>36</sup>

Në dhjetor 2004, RRRG-ja ka bashkëpunuar me agjencione brenda Misionit të Kombeve të Bashkuara në Kosovë (UNMIK) për publikimin e një analize për qëndrimet dhe përparësitë e grave të titulluar “Zëri i Grave” ku ishte diskutuar çështja e dhunës kundër grave.<sup>37</sup>

Në vitin 2004, Shoqata e Avokateve “Norma” ka bërë monitorimin dhe vlerësimin e efikasitetit të sistemit gjyqësor dhe juridik lidhur me çështjet e kujdestarisë dhe i ka publikuar rezultatet e tyre.

Në vjeshtë të vitit 2005, Qendra Kosovare për Studime Gjinore ka kryer një hulumtim të shkurtër për punën e shtëpive të sigurta me qëllim të hartimit të një raporti të shkurtër me titull “Raporti i Shoqërisë Civile Kosovare për Kombet e Bashkuara në temën e Dhunës kundër Grave në Kosovë”.<sup>38</sup> Kjo ishte bërë me mjetet vetanake të Qendrës.

Mbase studimi më gjithëpërfshirës me përqendrim specifik në DHKG-në në Kosovë në atë kohë, ishte publikuar nga UNIFEM-i në Kosovë në tetor 2000 me titull “Nuk ka vend të sigurt: Një vlerësim i Dhunës kundër Grave në Kosovë”, i punuar me përkrahjen e Departamentit Britanez të Zhvillimit Ndërkombëtar (DFID).

**9.2 A ka qendra hulumtuese që merren me çështjet e barazisë? Nëse po, a e përfshijnë ato çështjen e dhunës kundër grave? Kush udhëheq me këto qendra, cilat janë burimet e financimit?**

<sup>35</sup> Për më shumë informata lidhur me konstatimet vjetore shih [www.cpwc-qmgf.org](http://www.cpwc-qmgf.org).

<sup>36</sup> Shih [www.amnesty.org/actforwomen](http://www.amnesty.org/actforwomen). AI index: EUR 70/010/2004.

<sup>37</sup> Shih [www.womensnetwork.org](http://www.womensnetwork.org) for a copy of the report.

<sup>38</sup> Raporti në dispozicion në <http://kgscenter.org/program.php?id=26&lng=EN>.

Qendra për Mbrojtjen e Grave dhe Fëmijëve (QMGF) ka një program të vazhdueshëm monitorimi të të gjitha klienteve që kalojnë nëpër selinë apo nëpër degët e kësaj qendre. Të gjitha të dhënat e mbledhura gjatë tërë vitit publikohen në raportin vjetor të qendrës.<sup>39</sup> Pasi që kjo qendër është vendstrehimi më i madh në Kosovë dhe ruan lidhje me vendstrehimet e tjera, të dhënat e saj japin një ide të përgjithshme për situatën e dhunës kundër grave në bazë vjetore. QMGF financohet nga donatorë ndërkombëtarë si Kvinna till Kvinna dhe OSBE-ja.

Qendra Kosovare për Studime Gjinore është një institut vendor i hulumtimeve, i cili ka për mision që të kthej vëmendjen kah çështjet gjinore në të gjithë sektorët e shoqërisë kosovare duke ngritur vetëdijen gjinore, duke shtuar përqendrimin e sistemit arsimor në çështjet gjinore, duke zhvilluar studime dhe analiza gjinore, dhe duke siguruar përfshirjen e politikave të ndjeshme nga aspekti gjinor në të gjithë sektorët e jetës.<sup>40</sup> Megjithëse qendra nuk përqendrohet vetëm në DHKG, deri më tani ajo ka kryer disa projekte të vogla hulumtuese në këtë çështje, përfshirë edhe hulumtimin e përmendur më herët me titull “Raporti i Shoqërisë Civile Kosovare për Kombet e Bashkuara lidhur me Dhunën kundër Grave në Kosovë”.<sup>41</sup> Pos kësaj, qendra ka bërë edhe një studim për punën e OJQ-ve të grave në Kosovë. Kjo qendër përkrahet kryesisht nga Fondacioni Kosovar për Shoqëri të Hapur, nga Instituti i Shoqërisë së Hapur dhe nga Kvinna till Kvinna (Gratë për Gratë).

## **10. STATISTIKAT DHE MBLEDHJA E TË DHËNAVE**

### **10.1 A janë zhvilluar treguesit (indikatorët) e përbashkët nga shteti për të vlerësuar shkallën e dhunës kundër grave? Nëse po, jepni një përshkrim të shkurtër.**

Nuk janë zhvilluar indikatorët nga shteti e as janë prezentuar rezultatet e hulumtimeve qeveritare për shkallën e dhunës kundër grave.

### **10.2 A organizohet mbledhja sistematike dhe zyrtare e të dhënave statistikore dhe regjistrimi i rasteve të DHKG-së në polici, në zyrat e prokurorëve, në gjykata dhe në sistemin e mbrojtjes shëndetësore, në shërbimet e mbrojtjes sociale dhe të mbrojtjes së fëmijëve e të familjes, në zyrat e migrimit, në Zyrën Kombëtare të Statistikave etj.? Cilat janë format e dhunës të mbuluara nga to? Ju lutem prezentoni shifrat kryesore.**

Rreshterja Tahire Haxholli, Zyrtar për informim në Divizionin për Dhunë Familjare në Drejtorinë për Krime Serioze, thotë se numri i përgjithshëm i femrave në Kosovë që kanë përjetuar dhunë dhe që e kanë paraqitur në polici në vitin 2005 është 1,054, prej të cilave 71 janë strehuar.<sup>42</sup>

Gjykata Supreme ka refuzuar të na sigurojë çfarëdo informatash. Nuk ka mbledhje sistematike të të dhënave për DHKG-në në Kosovë.

<sup>39</sup> Shih web-faqen e QMGF për këto raporte: [www.cpwc-qmgf.org](http://www.cpwc-qmgf.org).

<sup>40</sup> Objektivat kryesorë të qendrës janë: “Të ngritet vetëdija, dija, dhe mirëkuptimi për çështjet gjinore në Kosovë duke kryer hulumtime, duke mbledhur informatat relevante, dhe duke shpërndarë informata në mbarë Kosovën dhe jashtë. Të zhvillohen më tutje studimet gjinore në Kosovë duke ndërtuar kapacitetet për hulumtime të ndjeshme në aspektin gjinor, duke ofruar mentorim, duke përfshirë hulumtues në hulumtime gjinore, duke zhvilluar metoda për hulumtime gjinore, dhe duke hartuar planprograme të studimeve gjinore”. Për më shumë informata shih web-faqen e QKSGJ: <http://kgscenter.org/about.php?lng=EN>.

<sup>41</sup> Raporti është në dispozicion në <http://kgscenter.org/program.php?id=26&lng=EN>.

<sup>42</sup> Intervistë me rreshteren Tahire Haxholli më 10 janar 2006, Zyrtare për Informim në Divizionin për Dhunë Familjare, Drejtoria për Studime Gjinore.



**10.3 Cilat janë metodat, dhe instrumentet kryesore për mbledhjen e të dhënave për rastet e DHKG-së përkitazi me secilin ofrues të të dhënave (me përqendrim të vacantë në policinë, gjykatat dhe personelin mjekësor): çfarë lloj të dhënash ata mbledhin dhe regjistrojnë? A janë të dhënat të organizuara sipas gjinisë; a i tregojnë marrëdhëniet ndërmjet viktimës dhe shkaktarit të dhunës dhe a i paraqesin aktet e mëparshme etj?**

Metoda e mbledhjes së të dhënave nuk është harmonizuar dhe mungon shkëmbimi i informatave në mes të organizatave të ndryshme dhe institucioneve zyrtare. Për shembull, QMGF-ja i regjistron të gjitha rastet që paraqiten në qendër; secila viktimë e plotëson një formular dhe në bazë të këtyre formularëve hartohet raporti vjetor për DHKG-në.

Në Departamentin e Policisë të Kosovës, njësia speciale e policisë që merret me dhunën përdor një formular të veçantë që shpjegon atë që ka ndodhur, të dhënat e diferencuara nga aspekti gjinor, marrëdhëniet ndërmjet viktimës dhe kundërvajtësit. **Të gjitha profesionet që merren me DHKG-në i regjistrojnë rastet e veta në mënyra të ndryshme, mirëpo nuk i shkëmbejnë ato me institucionet e tjera.**

**10.4 A ka një raport të rregullt vjetor në shkallë kombëtare të profesioneve të ndryshme për statistikat e tyre lidhur me rastet e DHKG-së ose të formave të ndryshme të saj? Nëse po, cilat profesione kanë raporte të tilla?**

Ekziston Zyra e Statistikave e Kosovës, mirëpo nuk ka raporte të rregullta për dhunën kundër grave. Me përjashtim të QMGF-së, asnjë profesion nuk publikon statistika për rastet e DHKG-së dhe, rrjedhimisht, nuk ka një raport kombëtar.

**10.5 Çfarë lloji i statistikave dhe i të dhënave janë në dispozicion për publikun e gjerë lidhur me DHKG-në?**

Qendra për Mbrojtjen e Grave dhe Fëmijëve publikon konstatimet e veta në një raport vjetor dhe aty i përfshinë informatat për të gjitha format e dhunës kundër grave: dhunën seksuale, dhunën familjare dhe incestin. Ky raport është në dispozicion të publikut nëse e kërkojnë. Ndonjëherë policia i bën publike të dhënat në gazeta ose përmes televizionit.

**10.6 Sa është numri i procedurave të inicuar (penale/civile) në raste të ndryshme të DHKG-së, në bazë të statistikave të policisë dhe të gjyqësisë? Çfarë është rezultati i procedurave gjyqësore: në bazë të numrit të rasteve të bartura në gjyqe (në përqindjen e procedurave të inicuar), dhe numri i dënimeve (në përqindje të procedurave të inicuar). Ju lutemi t'i referoheni shpërndarjes së llojeve të ndryshme të sanksioneve të aplikuar (nëse ka të tilla).**

Rreshterja Tahire Haxholli, Zyrtare për Informim në Divizionin për Dhunë Familjare në Drejtorinë për Krime Serioze, thotë se numri i përgjithshëm i grave në Kosovë që kanë përjetuar dhunë dhe që e kanë paraqitur atë në polici në vitin 2005 ishte 1,054, dhe 71 prej tyre janë dërguar në vendstrehim.<sup>43</sup>

Gjyqi Suprem i Kosovës ka refuzuar të ofrojë informatat e kërkuara. Nëse duam t'i nxjerrim këto të dhëna në bazë të Ligjit për Qasje në Informata do të na duhet shumë kohë.

<sup>43</sup> Intervistë me Rreshteren Tahire Haxholli më 10 janar 2006, Zyrtar i Informimit në Divizionin për Dhunën Familjare në Drejtorinë për Krime Serioze.

**10.7 A ka ndonjë lloj statistikash të OJQ-ve që merren me format e ndryshme të DHKG-së (për shpeshësinë e dhunës, numrin e njerëzve që kërkojnë ndihmë etj.)? Cilat janë të dhënat kryesore?**

Secili nga pesë strehimet kryesore mirëmban statistikën e veta lidhur me njerëzit të cilëve u është siguruar banimi, informatat demografike, etj. Raporti vjetor i QMGF-së<sup>44</sup> tregon se 96,218 gra janë përfituese të shërbimeve të veta, prej të cilëve 43,454 janë përfitues të drejtpërdrejtë dhe 52,764 janë përfitues të tërthortë. 1,271 prej tyre ishin viktimat e dhunës familjare, të dhunës së përgjithshme dhe të asaj institucionale, 59 ishin viktimat e trafikimit dhe të prostitucionit të detyruar, 26,970 kanë pranuar shërbime që u sigurohen viktimave, 74,401 kanë pranuar këshilla për viktimat, 3,650 kanë marrë këshilla përmes linjës S.O.S., 1,560 kanë shkuar në sesione të psiko-terapisë, 212 viktimat ishin strehuar, dhe 110 kanë qenë raste që kanë shkuar në procedurë gjyqësore.

Shtëpitë e tjera të sigurta nuk i publikojnë statistikën e veta. Megjithatë, QMGF-ja momentalisht është duke kryer një hulumtim për këtë çështje, dhe pritet që të sigurohen të dhëna më të sakta në të ardhmen e afërt.

**10.8 A ka një bazë gjithëpërfshirëse të të dhënave për dhunën seksuale? Nëse po, bëni një paraqitje të shkurtër të punës së saj. Sa është numri i kundërvajtësve të identifikuar dhe të paidentifikuar?**

QKSGJ-ja nuk ka qenë në gjendje të mbledhë informata për ekzistimin e një banke të të dhënave për rastet e dhunës seksuale.

## **11. Praktika gjyqësore**

**11.1 A ka ndonjë rast të DHKG-së në Zyrën e Ombudspersonit, në Gjykatën Kushtetuese, dhe në organe të tjera speciale në vend (si për shembull Komisione / Trajtim të Barabartë / Organe të Barazisë Gjimore)? Nëse po, tregoni numrin e këtyre rasteve dhe bëni një përmbledhje të shkurtër të rasteve.**

Sa i përket dhunës kundër grave, mund të thuhet se Institucioni i Ombudspersonit në Kosovë shërben vetëm për qëllime informimi. Për shembull, nëse ka rast të dhunës familjare që kërkon ndihmë nga ky institucion, zyrtarët atje i drejtojnë gratë në organizatat specifike që mund t'i ndihmojë ato. Gratë që kanë nevojë për ndihmë juridike drejtohen në shoqatën Norma ose në Qendrën për Mbrojtjen e Grave dhe Fëmijëve. "Ka pasur raste të dhunës familjare që na janë drejtuar ne" thotë Luljeta Domaniku, juriste në zyrën e Ombudspersonit. "Ne i kemi drejtuar ata në vende të tjera".<sup>45</sup> Në bazë të informatave që ka QKSGJ-ja, asnjë rast i dhunës familjare nuk është dërguar te autoritetet më të larta pos sistemit të rregullt gjyqësor; përjashtim bëjnë edhe disa raste që ndiqen për krime ndërkombëtare të luftës nga Gjyqi i Hagës.

<sup>44</sup> Qendra për Mbrojtjen e Grave dhe Fëmijëve, Raporti Vjetor 2004, Nr. 5, Prishtinë, 2005

<sup>45</sup> Intervistë më 1 shkurt 2006, me Luljeta Domanikun, avokate për Barazinë Gjimore në Zyrën e Ombudspersonit.

**11.2 A ka ndonjë rast të DHKG-së nga vendi që shqyrtohet nga ndonjë forum ndërkombëtar? Nëse po, ju lutem tregoni forumin përkatës ndërkombëtar, statusin e procedurës, numrin e rasteve dhe një përmbledhje të thuktë të tyre.**

Tribunali Ndërkombëtar i Hagës është përgjegjës për të gjitha krimet e luftës në Kosovë, përfshirë rastet e dhunës të shkaktuar kundër grave nga ana e forcave ushtarake dhe paraushtarake. Sipas QMGF-së, deri më sot, vetëm një person është akuzuar për dhunë seksuale dhe për dhunime sistematike dhe është dërguar në Hagë për t'u gjykuar.<sup>46</sup> Kjo OJQ tregon se një numër i madh i grave janë të gatshme të dëshmojnë para Tribunalit të Hagës për dhunimet e kryera kundër tyre. QMGF-ja shërben si ndërmjetëse ndërmjet viktimave të dhunimit dhe Tribunalit të Hagës. QKSGJ-ja nuk ka qenë në gjendje të informohet për hollësitë e rastit në këtë fazë.

**11.3 A ka ndonjë lëndë (vendim) gjyqësor të publikuar lidhur me dhunën kundër grave? Nëse po, jepni një përmbledhje të shkurtër të këtyre rasteve.**

Që prej vitit 2003, Qendra për Mbrojtjen e Grave dhe Fëmijëve ka monitoruar rastet gjyqësore që kishin të bënin me dhunën familjare. Ata kanë botuar një shembull në Raportin Vjetor të QMGF-së për vitin 2004:

Në këtë gjykim në Gjykatën e Qarkut në Prishtinë ishte rasti i një vajze 15 vjeçare, nxënëse; thuhet se në orët e pasditës të ditës kritike, kundërvajtësi e kishte marrë vajzën dhe e kishte dërguar në disa kafeteri dhe në mbrëmje e kishte dërguar në një hotel ku e kishte dhunuar tri herë. Viktima ka deklaruar se ishte marrë kundër dëshirës së vet dhe se kundërvajtësi (36 vjeçar) e kishte përdorur forcën dhe e kishte kërcënuar atë.

Megjithatë, gjykimi ishte shndërruar në një farsë ndërmjet gjykatësit e mbrojtësit, pasi që pyetjet që i bëheshin viktimës ishin “përshkruani pozitat që kishit kur bëtë seks për herë të parë, të dytë dhe të tretë”. Kishte edhe pyetje si “a kishte përjetuar viktima orgazmë”, ose “a ke qenë e virgjër”. Dhe pasi që viktima ishte përgjigjur se nuk kishte qenë e virgjër pasi që kishte pasur marrëdhënie seksuale me të dashurin e saj”, mbrojtësi kishte vazhduar me pyetjen “Kur ke pasur marrëdhënie seksuale me të “dashurin” tënd”.

I gjithë gjykimi ishte zhvilluar në këtë ton ironik. Zyrtarët e gjykatës kanë theksuar tërë kohën se dhunimi ishte trillim i viktimës, dhe vazhdimisht kishin dyshuar në dëshminë e viktimës.

Është normale të dyshohet, por edhe aq haptas të manifestohen paragjykimet para tërë gjykatës duke përdorur ironinë, shprehjet cinike dhe pyetjet derisa viktima është duke u përgjigjur dhe derisa është duke u zhvilluar procedura penale. Në këto rrethana dëmtohet dinjiteti i viktimës dhe viktima ofendohet rëndë”.<sup>47</sup>

**11.4 A ka ndonjë analizë apo studim rasti në këtë fushë? Nëse po, jepni një përmbledhje të shkurtër dhe tregoni për konstatimet kryesore.**

Në vitin 2003 dhe 2004, QMGF-ja përmes monitorimit e bëri studimin e disa rasteve në proceset gjyqësore. Këto studime të rastit mund të gjenden në Raportin Vjetor të QMGF-së për vitet 2003 dhe 2004. Në këtë analizë, QMGF-ja shpreh shqetësimin e vet për mënyrën e trajtimit të këtyre

<sup>46</sup> Qendra për Mbrojtjen e Grave dhe Fëmijëve, Raporti Vjetor 2003, Nr. 4, Prishtinë, 2004

<sup>47</sup> Qendra për Mbrojtjen e Grave dhe Fëmijëve, Raporti Vjetor 2003, Nr. 4, Prishtinë, 2004

**INDIKATORËT PËR MONITORIMIN E SITUATËS SË TANISHME NË KOSOVË PËRKITAZI ME DHUNËN KUNDËR  
GRAVE**

rasteve. Qendra ka ardhur në përfundim se në disa raste të dhunë gjyqtarët veprojnë me paragjykim.

## REKOMANDIMET

- Të hartohet një Plan Kombëtar i Veprimit për të luftuar Dhunën Kundër Grave;
- Të fillojë procedura për hartimin e një ligji special në Kosovë për DHKG-në;
- Të themelohet një institucion i posaçëm qeveritar ose departament që do të merrej me DHKG-në. Ky institucion ose departament ose organ special do të merrej me monitorimin, vlerësimin, dhe bashkërenditjen e masave të ndërmarra për luftimin e dhunës kundër grave;
- Të vendosen vija të veçanta buxhetore për të përkrahur veprimet në luftimin e dhunës kundër grave në institucionet e tanishme qeveritare;
- Të krijohen vija të veçanta buxhetore që mbulojnë DHKG-në në Selinë e Shërbimit Policor, në Zyrën e Prokurorëve, në sistemin gjyqësor, në Shërbimin Kombëtar të Mbrojtjes Sociale, të Mbrojtjes së Fëmijëve dhe të Familjes, si dhe Sistemin e Mbrojtjes Shëndetësore;
- Të parashihet mbështetja financiare nga Buxheti i Konsoliduar i Kosovës për OJQ-të që merren me dhunën kundër fëmijëve;
- Të krijohet një sistem financiar që do të merrej me kompensimin e dëmeve që u shkaktohet viktimave të dhunës;
- Të merret në konsiderim dhuna kundër grave dhe siguria e grave gjatë përgaditjes së planeve për planifikim në shkallë kombëtare, regjionale dhe të qyteteve;
- Të hartohen ligje speciale për mbrojtjen e profesionistëve që punojnë në vendstrehime ose në vende ku u ofrohen shërbime rasteve të DHKG-së;
- Të zhvillohen plane afatgjata të veprimit për profesionet në dosjen e DHKG-së;
- Të krijohen mundësi për themelimin e shtëpive të reja për vendstrehim;
- Të hartohen programe për trajtimin e kundërvajtësve;
- Të ofrohen trajnime në profesione të ndryshme përkitazi me DHKG-në;
- Të zhvillohen programe të vazhdueshme arsimore që merren ekskluzivisht me studimet gjinore;
- Të hartohet një rregullore ose një ligj që rregullon mënyrën e shikimit të dhunës kundër grave;
- Të hartohen udhëzimet, rregulloret e punës dhe urdhëresat për mediat kosovare lidhur me DHKG-së;

**Monitoruese**  
**LULJETA DEMOLLI**  
**Qendra Kosovare për Studime Gjinore**  
**Prishtinë, janar 2007**

This document was created with Win2PDF available at <http://www.win2pdf.com>.  
The unregistered version of Win2PDF is for evaluation or non-commercial use only.  
This page will not be added after purchasing Win2PDF.